



## KUR HISTORIA TAKON TEKNOLOGJINË NDËRLIDHJA, 95 VJET NË SHËRBIM TË KOMANDIMIT USHTARAK

» faqe 5



### PASHALIMANI, MOTOR I RINGRITJES SË INDUSTRIËS DETARE SHQIPTARE

Partneritet strategjik për zhvillimin e industrisë detare dhe formimin e specialistëve të rinj. Në Bazën Detare të Pashalimanit u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet kompanisë shtetërore KAYO, kompanisë italiane FINCANTIERI dhe Shkollës Industriale "Pavarësia" në Vlorë, duke shënuar një hap të rëndësishëm në zhvillimin e industrisë detare shqiptare dhe përgatitjen e brezit të ri të specialistëve në këtë sektor strategjik. Ceremonia u zhvillua në prani të Kryeministrit Edi Rama, Ministrit të Mbrojtjes Ermal Nufi...

faqe 2



### 95 VJET NË SHËRBIM TË KOMANDIMIT DHE KOMUNIKIMIT USHTARAK

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,  
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në historinë e çdo ushtrie moderne ka shërbime që nuk janë gjithmonë në vijën e parë të betejës, por pa të cilat asnjë operacion nuk mund të planifikohet, drejtohet apo të përfundojë me sukses. Një prej tyre është Shërbimi i Ndërlidhjes, shtylla e komunikimit ushtarak, hallka që lidh komandantin me vartësin, informacionin...

faqe 5



### PARTNERITET QË NDËRTON LIDERË, AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA NË FOKUSIN E PROGRAMIT "FULBRIGHT"

"Fulbright Specialist", një investim në leadership e së nesërmes. Në një kohë kur sfidat e sigurisë po bëhen gjithnjë e më komplekse dhe mjedisi strategjik kërkon institucione të afta të përshtaten me ritme të shpejta, investimi në dijen, leadershipin dhe kapitalin njerëzor, mbetet një nga garancitë më të forta të suksesit. Pikërisht në këtë frymë u zhvillua në Akademinë e Forcave...

faqe 4



# PASHALIMANI, MOTOR I RINGRITJES SË INDUSTRIISË DETARE SHQIPTARE

## Partneritet strategjik për zhvillimin e industrisë detare dhe formimin e specialistëve të rinj

Në Bazën Detare të Pashalimanit u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet kompanisë shtetërore **KAYO**, kompanisë italiane **FINCANTIERI** dhe Shkollës Industriale **“Pavarësia”** në Vlorë, duke shënuar një hap të rëndësishëm në zhvillimin e industrisë detare shqiptare dhe përgatitjen e brezit të ri të specialistëve në këtë sektor strategjik.

Ceremonia u zhvillua në prani të Kryeministrit Edi Rama, Ministrit të Mbrojtjes Ermal Nufi, Drejtorit Ekzekutiv të FINCANTIERI, Pierroberto Folgiero, Drejtorit Ekzekutiv të KAYO, Ardi Veliu, si dhe përfaqësuesve të institucioneve qendrore e vendore, stafit pedagogjik dhe nxënësve të Shkollës Industriale “Pavarësia”.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, e cilësoi nënshkrimin e memorandumit si një moment të rëndësishëm në realizimin e vizionit të nisur në vitin 2023 për ringritjen e industrisë ushtarake shqiptare dhe shndërrimin e saj në një faktor të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik dhe punësimit.

“Ky event është përmbushja e përpjekjeve tona për të ringritur industrinë ushtarake dhe për të forcuar partneritetet, në mënyrë që jo vetëm të rrisim kapacitetet tona industriale dhe ushtarake, por edhe të përgatisim të rinjtë dhe të rejat që do të kontribuojnë në industrializimin, punësimin dhe zhvillimin ekonomik të vendit”, - u shpreh ministri Nufi.

Ai theksoi se partneriteti me FINCANTIERI-n, një prej kompanive lider në industrinë botërore të ndërtimit të anijeve, sjell në Shqipëri ekspertizë të avancuar, teknologji moderne dhe mundësi të reja zhvillimi, duke forcuar më tej bashkëpunimin strategjik mes Shqipërisë dhe Italisë.

Memorandumi synon krijimin e një modeli të qëndrueshëm bashkëpunimi ndërmjet industrisë dhe arsimit

**Memorandumi ndërmjet KAYO-s, FINCANTIERI-t dhe Shkollës Industriale “Pavarësia” hap një kapitull të ri në formimin profesional, zhvillimin industrial dhe partneritetin strategjik Shqipëri-Itali**



profesional, përmes zhvillimit të praktikave profesionale, moduleve të specializuara të trajnimit dhe programeve të formimit për nxënësit e Shkollës Industriale “Pavarësia”. Marrëveshja parashikon gjithashtu krijimin e mundësive konkrete të punësimit për të rinjtë në industrinë e ndërtimit dhe riparimit të anijeve.

Programi i formimit do të përfshijë nxënës të profileve: Mekanikë, Elektroteknikë, Termohidraulikë, Shërbime Transporti, si dhe Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, duke i përgatitur ata për nevojat e qendrës së re industriale detare që po zhvillohet në Pashaliman.

Ky partneritet përfaqëson një investim të rëndësishëm në kapitalin njerëzor dhe në zhvillimin e industrisë kombëtare të mbrojtjes, duke lidhur arsimin profesional me tregun e punës dhe me kërkesat e industrisë moderne detare.

Në përfundim të ceremonisë, të pranishmit zhvilluan një vizitë në Kantierin e Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve në Pashaliman, ku u njohën nga afër me ecurinë e punimeve dhe perspektivën e zhvillimit të këtij projekti strategjik për industrinë detare shqiptare.

# SHQIPËRI-GREQI, PARTNERITET I KONSOLIDUAR NË MBROJTJE DHE SIGURI

**Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi zhvilloi vizitë zyrtare në Athinë, ku u takua me homologun grek Nikos Dendias dhe mori pjesë në Konferencën e Mbrojtjes së Athinës, duke riafirmuar angazhimin e Shqipërisë për një NATO më të fortë dhe një rajon më të sigurt.**

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit strategjik ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë, ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi, zhvilloi një vizitë zyrtare në Athinë, ku u prit nga homologu i tij, ministri i Mbrojtjes Kombëtare të Greqisë, z. Nikos Dendias.

Takimi u zhvillua në një klimë miqësore dhe konstruktive, duke reflektuar nivelin e lartë të marrëdhënieve dypalëshe dhe vullnetin e përbashkët për zgjerimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Dy ministrat vlerësuan progresin e deritanishëm të bashkëpunimit ushtarak, si edhe rëndësinë e koordinimit të vazhdueshëm në kuadër të NATO-s, në funksion të ruajtjes së paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë.

Ministri Nufi e cilësoi Greqinë një mike dhe aleate të rëndësishme të Shqipërisë, duke shprehur mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që Athina i ka dhënë vendit tonë në procesin e integritetit evropian.

Një vend të veçantë në axhendën e bisedimeve zuri bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes kibernetike dhe sigurisë së rrjeteve. Ministri Nufi theksoi se Shqipëria ka bërë përparim të dukshëm në forcimin e qëndrueshmërisë kibernetike, falë bashkëpunimit të ngushtë me aleatët e NATO-s dhe partnerët strategjikë, ndërsa shprehu gatishmërinë për zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh edhe në këtë fushë me rëndësi strategjike.

Në takim u diskutua gjithashtu mbi rritjen e ndërveprueshmërisë ndërmjet Forcave të Armatosura të dy vendeve, përmes aktiviteteve të përbashkëta stërvitore, edukimit ushtarak, programeve të trajnimit dhe shkëmbimit të ekspertizës profesionale. Një tjetër çështje me interes të përbashkët ishte koordinimi dhe ndihma reciproke për përballimin e emergjencave civile gjatë sezonit veror, duke vlerësuar rëndësinë e reagimit të koordinuar ndaj fatkeqësive natyrore dhe situatave emergjente.

Gjatë qëndrimit në Athinë, dhe me ftesë të ministrit



grek Nikos Dendias, ministri Ermal Nufi mori pjesë edhe në **Konferencën e Mbrojtjes së Athinës (Athens Defence Conference 2026)**, organizuar nga Forumi Ekonomik i Delfit dhe Fondazione Helen për Evropën dhe Politikën e Jashtme (ELIAMEP). Konferenca mbledhi ministra të mbrojtjes, drejtues të lartë ushtarakë të Aleancës, diplomatë, ekspertë të sigurisë dhe përfaqësues të industrisë së mbrojtjes nga vendet e NATO-s dhe Evropës, duke u shndërruar në një forum të rëndësishëm për diskutimin e sfidave të sigurisë ndërkombëtare.

Në fjalën e tij, ministri Nufi theksoi se në një Evropë që përballlet me sfida gjithnjë e më komplekse të sigurisë, koordinimi strategjik ndërmjet aleatëve është një domosdoshmëri. Ai nënvizoi se Shqipëria mbetet një aleate e përkushtuar dhe e besueshme e NATO-s, duke kontribuar në mënyrë aktive në operacionet dhe misionet e Aleancës, si dhe në nismat ndërkombëtare për sigurinë.

“Ne po rrisim investimet tona dhe po modernizojmë Forcat tona të Armatosura. Kontributi ynë shtrihet në operacionet



e NATO-s, misionet e Bashkimit Evropian dhe nismat ndërkombëtare për sigurinë. Ne mbështesim një Evropë më të fortë brenda një NATO-je më të fuqishme”, - u shpreh ministri Nufi.

Duke u ndalur te zhvillimet në rajon, ai theksoi se Ballkani Perëndimor duhet të mbetet në qendër të vëmendjes strategjike të Bashkimit Evropian dhe NATO-s, pasi përballlet me sfida të shumta që lidhen me ndikimet keqdashëse, dezinformimin, luftën hibride dhe përpjekjet destabilizuese që cenojnë sigurinë dhe stabilitetin rajonal.

Vizita zyrtare në Athinë dhe pjesëmarrja në Konferencën e Mbrojtjes dëshmuar edhe një herë se marrëdhëniet shqiptaro-greke në fushën e mbrojtjes janë ndërtuar mbi besimin reciprok, dialogun e vazhdueshëm dhe interesat e përbashkëta strategjike. Në të njëjtën kohë, ato riafirmuan angazhimin e Shqipërisë për të qenë një kontribuuese aktive në sigurinë kolektive të Aleancës dhe në forcimin e bashkëpunimit rajonal, si pjesë e arkitekturës euroatlantike të sigurisë.

# SHËRBIMI I NDËRLIDHJES, 95 VJET NË MBËSHTETJE TË OPERACIONEVE USHTARAKE

Komanda Kibernetike e Ndërlidhjes kremtoi 95-vjetorin e Shërbimit të Ndërlidhjes, duke vlerësuar kontributin e brezave të specialistëve dhe rolin strategjik të këtij komponenti në modernizimin e Forcave të Armatosura.

Komanda Kibernetike e Ndërlidhjes, pjesë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kremtoi 95-vjetorin e krijimit të Shërbimit të Ndërlidhjes, një prej strukturave më të rëndësishme në garantimin e komandimit, komunikimit dhe mbështetjes së operacioneve ushtarake.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast morën pjesë ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, gjeneralë, oficerë, nënoficerë, ushtarë, punonjës civilë, veteranë të Shërbimit të Ndërlidhjes, si dhe të ftuar të tjerë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri Nufi e cilësoi Shërbimin e Ndërlidhjes si një komponent jetik të Forcave të Armatosura, duke theksuar se asnjë operacion ushtarak nuk mund të realizohet pa një sistem komunikimi të sigurt, të besueshëm dhe të pandërprerë.

Ai shprehu mirënjohje për të gjithë brezat e efektivëve që kanë shërbyer ndër vite në këtë strukturë, duke vlerësuar kontributin e veteranëve dhe profesionalizmin e personelit që sot garanton funksionimin e sistemeve moderne të komunikimit dhe mbrojtjes kibernetike.

Duke u ndalur te procesi i modernizimit të Forcave të Armatosura, ministri Nufi theksoi se Shqipëria, si vend anëtar i NATO-s, ka rritur ndjeshëm kapacitetet në fushën e ndërlidhjes dhe mbrojtjes kibernetike, duke siguruar ndërveprueshmëri të plotë me sistemet e Aleancës.

“Si vend anëtar i NATO-s, Shqipëria ka përgjegjësi dhe ambicie të mëdha. Sot, sistemet tona të ndërlidhjes janë plotësisht të ndërveprueshme me ato të Aleancës, duke garantuar komunikim të sigurt dhe të besueshëm në çdo operacion të përbashkët. Ky është rezultat i profesionalizmit të personelit, por edhe i investimeve të vazhdueshme në teknologji dhe zhvillimin e burimeve njerëzore”, - u shpreh ministri Nufi.

Ai vlerësoi gjithashtu partneritetin strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe mbështetjen e aleatëve të NATO-s në zhvillimin e kapaciteteve kombëtare të ndërlidhjes dhe mbrojtjes kibernetike, duke theksuar se falë këtij bashkëpunimi janë modernizuar infrastruktura, standardet e trajnimit dhe sistemet e komunikimit të Forcave të Armatosura.

Ministri Nufi nënvizoi se modernizimi i Forcave të Armatosura mbetet një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare, me investime të vazhdueshme në teknologjitë e avancuara, infrastrukturën kritike dhe zhvillimin profesional të personelit, me synimin për të garantuar kapacitete të plota në përmbushje të detyrimeve kombëtare dhe aleate.

Ceremonia e 95-vjetorit shërbeu jo vetëm si një moment për



të nderuar historinë dhe traditën e Shërbimit të Ndërlidhjes, por edhe për të riafirmuar rolin e tij në transformimin e Forcave të Armatosura, në epokën e teknologjisë së informacionit dhe të mbrojtjes kibernetike, si një nga shtyllat kryesore të sigurisë kombëtare dhe të angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të NATO-s.

Në mesazhin e tij përshëndetës, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, **gjenerallejtënant Arben Kingji**, vlerësoi kontributin historik të Shërbimit të Ndërlidhjes në garantimin e komandimit dhe kontrollit të Forcave të Armatosura, duke theksuar se ky komponent mbetet një nga shtyllat kryesore të funksionimit të çdo operacioni ushtarak.

“Duke nderuar 95-vjetorin e Shërbimit të Ndërlidhjes,



shprehim mirënjohjen dhe respektin për të gjithë brezat e ushtarakëve dhe punonjësve civilë që, me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi, kanë ndërtuar dhe zhvilluar këtë shërbim ndër vite. Kontributi i tyre ka qenë vendimtar në garantimin e sistemeve të komandim-kontrollit dhe komunikimit të Forcave të Armatosura, duke siguruar funksionimin e tyre në çdo mision dhe në çdo situatë operacionale. Uroj që personeli i Komandës Kibernetike dhe Ndërlidhjes të vijojë me të njëjtin profesionalizëm dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave, duke kontribuar në modernizimin e mëtejshëm të Forcave të Armatosura, në rritjen e kapaciteteve të komunikimit dhe mbrojtjes kibernetike, si dhe në përmbushjen me sukses të misioneve kombëtare dhe të angazhimeve në kuadër të NATO-s”.



## Mbrojtja Ajrore, nga trashëgimia tek kapacitetet e së ardhmes

Përvjetori i Armës së Mbrojtjes Kundërajrore përkon me trevjetorin e krijimit të strukturës së Mbrojtjes Ajrore të Bazuar në Tokë, duke shënuar një etapë të re në modernizimin e Forcës Ajrore.

Forca Ajrore shënon këtë vit dy përvjetorë me rëndësi të veçantë për historinë dhe zhvillimin e saj: 95-vjetorin e krijimit të Armës së Mbrojtjes Kundërajrore dhe trevjetorin e krijimit të strukturës së Mbrojtjes Ajrore të Bazuar në Tokë (Ground Based Air Defence – GBAD).

Ky jubile përfaqëson një moment vlerësimi për kontributin e brezave të ushtarakëve që shërbyen me profesionalizëm në Armën e Mbrojtjes Kundërajrore, duke mbrojtur hapësirën ajrore të vendit dhe duke ndërtuar traditën mbi të cilën mbështetjet zhvillimi i kapaciteteve moderne të mbrojtjes ajrore.

Në të njëjtën kohë, ky përvjetor pasqyron transformimin që ka përjetuar Forca Ajrore në vitet e fundit, në përputhje me objektivat e modernizimit të Forcave të Armatosura dhe standardet e Aleancës së NATO-s.

Si pjesë e Sistemit të Integruar të Mbrojtjes Ajrore dhe Raketore të NATO-s (NATO Integrated Air and Missile Defence System – NATINAMDS), Shqipëria po vijon të forcojë kapacitetet kombëtare të mbrojtjes ajrore përmes zhvillimit të strukturës së Mbrojtjes Ajrore të Bazuar në Tokë, modernizimit të sistemeve të vëzhgimit dhe integritetit të teknologjive bashkëkohore.

Në këtë kuadër, rëndësi të veçantë merr edhe zbatimi i projektit për Sistemin e Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore (SIVHA), i cili do të mundësojë kompletimin e kapaciteteve me radarë modernë dhe mjete të avancuara të



vëzhgimit, duke rritur ndërgjegjësimin e situatës ajrore dhe ndërveprueshmërinë me strukturat e Aleancës.

Përvjetori i 95-të i Armës së Mbrojtjes Kundërajrore nuk është vetëm një rikthim në historinë e një arme me traditë, por edhe një dëshmi e transformimit të saj në një komponent modern të mbrojtjes



kombëtare. Ai riafirmon angazhimin e Forcës Ajrore për të vijuar investimet në teknologji, infrastrukturë dhe zhvillimin profesional të personelit, me synimin për të garantuar mbrojtjen efektive të hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe përmbushjen e detyrimeve në kuadër të NATO-s.

### “Fulbright Specialist”, një investim në leadershipin e së nesërme

Në një kohë kur sfidat e sigurisë po bëhen gjithnjë e më komplekse dhe mjedisi strategjik kërkon institucione të afta të përshtaten me ritme të shpejta, investimi në dijen, leadershipin dhe kapitalin njerëzor, mbetet një nga garancitë më të forta të suksesit. Pikërisht në këtë frymë u zhvillua në Akademinë e Forcave të Armatosura trajnimi tri javor në kuadër të programit prestigjioz amerikan **“Fulbright Specialist Program”**, me pjesëmarrjen e profesoreshës amerikane Ashley Mandeville.

I zhvilluar nga data 16 qershor deri më 3 korrik 2026, aktiviteti u shndërrua në një platformë të rëndësishme shkëmbimi profesional ndërmjet ekspertëve amerikanë dhe personelit akademik e ushtarak shqiptar. Më shumë sesa një trajnim, ai përfaqësoi një laborator idesh, ku përvoja amerikane në fushën e leadershipit, menaxhimit strategjik dhe zhvillimit të burimeve njerëzore u ndërthur me përvojën e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Ky aktivitet u zhvillua në zbatim të vendimeve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, duke dëshmuar rëndësinë që institucionet shqiptare i kushtojnë bashkëpunimit akademik ndërkombëtar dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional të personelit ushtarak.

Në trajnim morën pjesë drejtues të Akademisë së Forcave të Armatosura, pedagogë, studiues dhe specialistë të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, Institutit të Kërkimit Shkencor Ushtarak dhe strukturave të tjera akademike, duke krijuar një mjedis bashkëpunues ku eksperiencat u ndanë lirshëm dhe diskutimet morën karakter ndërdisiplinor.

Programi nisi me prezantimin e Akademisë së Forcave të Armatosura, misionit të saj, strukturës organizative dhe programeve të studimit. Ky prezantim i krijoi profesoreshës Mandeville një panoramë të qartë mbi zhvillimin e arsimit të lartë ushtarak në Shqipëri dhe orientimin e tij drejt standardeve të NATO-s.

Gjatë javëve në vijim u trajtuan tema me rëndësi strategjike për zhvillimin institucional të Forcave të Armatosura, si menaxhimi i burimeve njerëzore përgjatë gjithë ciklit të karrierës ushtarake, rekrutimi modern, zhvillimi dhe mbajtja e talenteve, planifikimi strategjik, procesi PPBES, kërkimi shkencor, ndërkombëtarizimi i arsimit ushtarak, standardet e cilësisë akademike, leadershipi në mjedise komplekse, qëndrueshmëria kombëtare përballë kërcënimeve kibernetike dhe drejtimi i operacioneve shumëkombëshe.

Një vlerë e shtuar e këtij programi ishte metodologjia interaktive e përdorur nga profesoresha **Ashley Mandeville**. Përveç leksioneve teorike, pjesëmarrësit punuan në grupe mbi raste konkrete studimore, duke analizuar vendimmarrjen strategjike, sfidat e leadershipit adaptiv, etikën profesionale, proceset e promovimit dhe menaxhimit të karrierës, si edhe modelet bashkëkohore të komandimit në operacionet e NATO-s.

Këto diskutime nuk mbetën vetëm në nivel teorik. Ato krijuan një atmosferë reflektimi profesional, ku pedagogët, studiuesit dhe oficerët shqiptarë krahasuan praktikatat e tyre me modelet më të mira amerikane dhe aleate, duke identifikuar mundësi konkrete për zhvillimin e mëtejshëm të arsimit ushtarak.

Një moment me rëndësi të veçantë ishte pjesëmarrja e profesoreshës Mandeville në Konferencën Shkencore të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, ku u diskutuan sfidat bashkëkohore të sigurisë dhe roli i kërkimit shkencor në mbështetje të vendimmarrjes strategjike.

Programi nuk u kufizua vetëm brenda mureve të Akademisë. Gjatë qëndrimit të saj në Shqipëri, profesoresha zhvilloi takime me drejtues akademikë të Universitetit të Tiranës, **Universitetit “Ismail Qemali”** në Vlorë dhe **Universitetit “Aleksandër Moisiu”** në Durrës, duke zgjeruar rrjetin e bashkëpunimit ndëruniversitar dhe duke promovuar shkëmbimin e praktikave më të mira në arsimin e lartë.

Po aq domethënëse ishte edhe njohja nga afër me kampusin e ri të Akademisë së Forcave të Armatosura, një investim që pasqyron vizionin për modernizimin e arsimit ushtarak shqiptar dhe krijimin e një mjedisi bashkëkohor studimi e kërkimi.

Një tjetër moment me rëndësi diplomatike ishte vizita e **znj. Sibora Kodra**, përfaqësuese e Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Gjatë takimit ajo vlerësoi organizimin, seriozitetin dhe rezultatet e arritura gjatë zhvillimit të programit, duke shprehur



## PARTNERITET QË NDËRTON LIDERË, Akademia e Forcave të Armatosura në fokusin e programit “Fulbright”



kënaqësinë për nivelin e bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Forcave të Armatosura dhe profesoreshës **Ashley Mandeville**. Ky vlerësim përbën një dëshmi konkrete të besimit reciprok dhe të partneritetit të konsoliduar shqiptaro-amerikan në fushën e arsimit, mbrojtjes dhe zhvillimit të kapaciteteve njerëzore.

Programi **“Fulbright Specialist”** është shumë më tepër sesa një iniciativë akademike. Ai përfaqëson filozofinë e bashkëpunimit afatgjatë ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara, të bazuar mbi shkëmbimin e dijes, ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe forcimin e marrëdhënieve strategjike.

Për Akademinë e Forcave të Armatosura, ky trajnim përbën një tjetër hap në procesin e transformimit të saj në një institucion modern të arsimit të lartë ushtarak, të integruar në komunitetin akademik euroatlantik dhe të aftë të përgatisë drejtuesit e së ardhmes për Forcat e Armatosura shqiptare.

Në përfundim të aktivitetit, pjesëmarrësit u pajisën me certifikata, por vlera më e madhe e këtij programi mbetet përvoja e fituar, rrjeti i kontakteve profesionale dhe idetë e reja që do të vijnë në ndikojnë në zhvillimin e leadershipit, menaxhimit strategjik dhe arsimit ushtarak në Shqipëri.

Në një botë ku siguria ndërtohet mbi dijen po aq sa mbi teknologjinë, bashkëpunime të tilla janë investime në të ardhmen. Ato dëshmojnë se partneriteti shqiptaro-amerikan vazhdon të zhvillohet jo vetëm në dimensionin operacional, por edhe në atë akademik e shkencor, duke e bërë Akademinë e Forcave të Armatosura një qendër gjithnjë e më të rëndësishme të ekselencës në arsimin ushtarak.



Në përfundim të programit, pjesëmarrësit u pajisën me **certifikata pjesëmarrjeje**, të cilat vlerësuan angazhimin dhe kontributin e tyre gjatë gjithë ciklit të trajnimit. Ceremonia e shpërndarjes së certifikatave shënoi edhe mbylljen zyrtare të aktivitetit, duke kurorëzuar tri javë intensive shkëmbimi akademik, diskutimesh profesionale dhe bashkëpunimi ndërinstitucional.

Më shumë se një dokument vlerësimi, këto certifikata simbolizuan përkushtimin e Akademisë së Forcave të Armatosura për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit të saj dhe forcimin e kulturës së të nxëniet gjatë gjithë jetës. Ato përfaqësojnë gjithashtu frytin e një partneriteti të suksesshëm mes Akademisë së Forcave të Armatosura, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri dhe programit prestigjioz **Fulbright Specialist**, duke dëshmuar se investimi në dije, leadership dhe bashkëpunim ndërkombëtar mbetet një nga shtyllat kryesore të modernizimit të arsimit ushtarak shqiptar.

Në një mjedis sigurie që evoluon vazhdimisht, nisur nga të tilla forcojnë jo vetëm kapacitetet profesionale të personelit ushtarak dhe civil, por edhe partneritetin strategjik shqiptaro-amerikan, duke e bërë Akademinë e Forcave të Armatosura një qendër gjithnjë e më të rëndësishme të ekselencës akademike dhe kërkimit shkencor në shërbim të mbrojtjes kombëtare.



# 95 VJET NË SHËRBIM TË KOMANDIMIT DHE KOMUNIKIMIT USHTARAK

Nga telat e parë të ndërlidhjes te mbrojtja kibernetike, rrugëtimi i një shërbimi që ka garantuar vazhdimësinë e komandimit në çdo etapë të historisë së Forcave të Armatosura



Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,  
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në historinë e çdo ushtrie moderne ka shërbime që nuk janë gjithmonë në vijën e parë të betejës, por pa të cilat asnjë operacion nuk mund të planifikohet, drejtohet apo të përfundojë me sukses. Një prej tyre është Shërbimi i Ndërlidhjes, shtylla e komunikimit ushtarak, hallka që lidh komandantin me vartësin, informacionin me vendimmarrjen dhe teknologjinë me sigurinë kombëtare.

Në vitin 2026, ky shërbim shënon 95-vjetorin e krijimit të tij, një rrugëtim që përshkon pothuajse një shekull histori të shtetit shqiptar, duke kaluar nëpër periudha të ndryshme zhvillimi, transformimesh teknologjike dhe sfidash operacionale.

Nga mjetet e para të komunikimit me tela e radio, deri te rrjetet e sigurta dixhitale, sistemet e komandimit dhe kontrollit (C4), komunikimet satelitore dhe mbrojtja kibernetike, Shërbimi i Ndërlidhjes ka qenë vazhdimisht në pararojë të modernizimit të Forcave të Armatosura.

Sot, në një mjedis sigurie gjithnjë e më kompleks, ku informacioni është po aq vendimtar sa edhe fuqia ushtarake, roli i ndërlidhjes ka marrë një dimension të ri strategjik. Operacionet shumëkombëshe, ndërveprueshmëria me aleatët e NATO-s, transformimi dixhital dhe mbrojtja e infrastrukturave kritike kërkojnë sisteme komunikimi të sigurta, të qëndrueshme dhe të afta për të funksionuar në çdo situatë.

Në këtë përvjetor të rëndësishëm, gazeta “Ushtria” sjell për lexuesit një intervistë ekskluzive me Komandantin e Komandës Kibernetike dhe Ndërlidhjes, Gjeneral Brigade Hamdi Doda, një oficer që e ka ndërtuar gjithë karrierën e tij brenda këtij shërbimi. Me mbi tri dekada eksperiencë në strukturat e ndërlidhjes, në komandat operacionale, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe në strukturat e NATO-s, ai është një prej njohësve më të mirë të evolucionit të komunikimeve ushtarake shqiptare. Në këtë bisedë ai rrëfen historinë e një shërbimi që ka ndryshuar bashkë me kohën, sfidat që solli integrimi në NATO, zhvillimin e kapaciteteve të reja kibernetike, investimet në teknologji, përgatitjen e personelit dhe vizionin për të ardhmen.

95 vite histori nuk janë vetëm një përvjetor. Janë dëshmi e profesionalizmit, e përkushtimit dhe e aftësisë për t'u përshtatur me çdo epokë. Janë historia e mijëra specialistëve të ndërlidhjes që, shpesh larg vëmendjes publike, kanë garantuar atë që për çdo ushtri është jetike: komunikimin, komandimin dhe sigurinë e informacionit.

**Gjeneral Brigade Hamdi Doda, Komandant i Komandës Kibernetike dhe Ndërlidhjes së Forcave të Armatosura**

Me mbi 33 vite shërbim në Forcat e Armatosura, gjeneral brigade Hamdi Doda është një nga drejtuesit më me përvojë në fushën e komunikimeve ushtarake dhe mbrojtjes kibernetike në Shqipëri.



Gjeneral Brigade HAMDI DODA  
Komandant i Komandës Kibernetike dhe Ndërlidhjes

Karrierën e nisi pas diplomimit në Akademinë Ushtarake “Skënderbej”, duke shërbyer fillimisht si komandant toge ndërlidhjeje. Gjatë viteve ai ka përmbushur me sukses detyra në të gjitha nivelet e drejtimit, nga njësitë taktike deri në strukturat strategjike të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, ku drejtoi Drejtorinë e Ndërlidhjes (J6), përpara se të merrte komandën e Agjencisë së Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit dhe më pas të Komandës Kibernetike dhe Ndërlidhjes.

Përvoja e tij ndërkombëtare përfshin shërbimin në Përfaqësinë Ushtarake të Shqipërisë pranë NATO-s, pjesëmarrjen në misionin “Iraqi Freedom”, në Irak dhe në misionin KFOR në Kosovë. Ai është diplomuar në programe të specializuara në Shqipëri, Turqi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermani dhe Estoni, me fokus në komunikimet ushtarake, sistemet CIS, menaxhimin e mbrojtjes dhe sigurinë kibernetike.

Në shkurt të vitit 2025, u promovua me gradën madhore

“Gjeneral Brigade”. Gjatë karrierës së tij është vlerësuar me disa medalje dhe dekorata për kontributin në zhvillimin e Forcave të Armatosura dhe për shërbimin në operacionet ndërkombëtare.

Në këtë intervistë, gjeneral brigade Hamdi Doda ndan këndvështrimin e tij mbi historinë 95-vjeçare të Shërbimit të Ndërlidhjes, sfidat e së tashmes dhe perspektivën e këtij komponenti strategjik në epokën e transformimit dixhital dhe të mbrojtjes kibernetike.

**I nderuar Gjeneral, si ndikon transformimi digjital në modernizimin e Forcave të Armatosura?**

Sofistikimi teknologjik, rritja e disponueshmërisë së rrjeteve të avancuara të komunikimit dhe siguria kibernetike kanë shndërruar mjedisin operacional në më të ndërlidhshëm e me kompleks se kurrë më parë. Sistemet dhe rrjetet e informacionit, mund të ndikohen nga incidentet e sigurisë, siç janë gabimet njerëzore, ngjarjet natyrore, dështimet teknike ose sulmet kibernetike. Sistemet e Ndërlidhjes dhe Informacionit në Forcat e Armatosura duhet t'i përgjigjen zhvillimit teknologjik të vazhdueshëm me qëllim që informacioni që prodhohet, ruhet, përpunohet, shpërndahet ose transmetohet në këto sisteme të jetë i sigurt.

Mjedisi i sotëm i sigurisë është shumë i ndjeshëm, por në këtë këndvështrim, transformimi digjital luan një rol të rëndësishëm në Forcat e Armatosura, duke sjellë jo vetëm përmirësime teknologjike, por edhe ndryshime në strategji dhe operacionalitet. Gjithashtu, teknologjia forcon aftësitë zbuluese, parandaluese ato mbrojtëse dhe reaguese ndaj kërcënimeve të reja digjitale dhe përmirëson ndjeshëm kapacitetet e analizimit të të dhënave në kohë reale. Digjitalizimi ndikon drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit të punës përmes automatizimit të proceseve, duke siguruar kushte për vendimmarrje të shpejtë dhe rivendosje në operacionalitet të Sistemeve të Komunikimit dhe Informacionit. Për më tepër, platformat digjitale përmirësojnë parandalimin e sulmeve përmes teknologjive të avancuara të sigurisë, integrimin e sigurisë kibernetike në të gjitha nivelet e operacioneve ushtarake si dhe bashkëpunimin me aleatët në operacione ndërkombëtare.

Modernizimi i armatimit dhe konkretisht përdorimi i dronëve e robotëve në operacione ka ndryshuar në mënyrë dramatike fushën e betejës, duke transformuar strategjitë



dhe taktikat ushtarake të luftimit si sulmuese ashtu edhe mbrojtëse. Lufta në Ukraine konsiderohet si konflikti i parë më i digjitalizuar që ka ndodhur ndonjëherë, ku dronët e **kanë revolucionarizuar luftën moderne ajrore, duke rritur ndërgjegjësimin për situatën dhe në nivelin taktik dhe operacional. Konfliktet janë kthyer në terrene testimi “live” i teknologjisë së dronëve, me implikime globale për mënyrën se si mund të zhvillohen luftërat e ardhshme. Më konkretisht disa avantazhe të përdorimit të tyre i shohim të pasqyruar në vijim:**

Dronët u ofrojnë palëve inteligjencë pothuajse në kohë reale mbi lëvizjet e trupave kundërshtare, pozicionet e artilerisë dhe fortifikimet. Ndryshe nga satelitët ose avionët me pilot, dronët (veçanërisht dronët e vegjël komercialë) janë të lirë, të disponueshëm gjerësisht dhe mund të lëshohen shpejt dhe të sigurojnë informacion të vazhdueshëm për situatën e fushëbetejës, duke mundësuar vendimmarrje dhe shënjestrim të shpejtë. Gjithashtu dronët zvogëlojnë humbjet në njerëz, kjo krahasuar me metodat tradicionale të luftimit.

Trajnimi i personelit ushtarak po bëhet më realist dhe efektiv përmes teknologjive si realiteti virtual. Transformimi kërkon investime të mëdha, trajnime të vazhdueshme, kohë të gjatë dhe një strategji të qartë për të minimizuar rreziqet si mbivarësia nga teknologjia dhe sulmet kibernetike. Transformimi digjital është thelbësor për një ushtri moderne, të aftë të përballet me sfidat komplekse të sigurisë së sotme dhe të së ardhmes. Këto ndikime ndihen në:

**1. Rritjen e efikasitetit operacional;**  
**2. Përmirësimin e mbrojtjes kibernetike;**  
**3. Fuqizimin e kapaciteteve të inteligjencës;**  
**4. Modernizimin e armëve dhe platformave luftarake;**  
**5. Trajnimin dhe simulime më realiste;**  
**6. Bashkëpunimin ndërkombëtar.**  
**Transformimi dixhital nuk është thjesht një përmirësim teknologjik, por një ndryshim strategjik që fuqizon Forcat e Armatosura për të qenë më të shpejta, më të afta dhe më të sigurta në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur dhe të kërcënuar nga rreziqet asimetrike. Digjitalizimi i mbrojtjes është pjesë kyçe e modernizimit të sigurisë kombëtare.**

**Si po i përballon ushtria shqiptare sfidat në rritje të sulmeve kibernetike?**

Sulmet kibernetike, të cilat po dominojnë fushëbetejën e sotme po i mjegullojnë dhe sfidojnë operacionet multi-domain në tokë det, ajër, hapësirë, si dhe në hapësirën kibernetike. Sfidat që e karakterizojnë këtë kërcënim të ri dhe orientimi i tyre për të ardhmen kërkojnë padyshim një bashkërendim dhe harmonizim të procesit të modernizimit në Forcat e Armatosura. FARSH-të kanë hyrë në rrugën e një reforme të pakthyeshme që konsiston në një transformim të thellë të strategjisë, doktrinave, strukturave organizative, infrastrukturave ushtarake, sistemeve e pajisjeve, përfshirë këtu, mbrojtjen kibernetike dhe Sistemet e Ndërlidhjes dhe Informacionit (SNI).

Vitet e fundit janë bërë investime të rëndësishme në infrastrukturën e teknologjisë dhe informacionit. Krijimi Komandës Kibernetike dhe Ndërlidhjes është padyshim rezultat i mbështetjes së vazhdueshme e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së për përgjigje efektive ndaj sulmeve kibernetike. Ky është një hap i rëndësishëm, jo vetëm për t’iu përshtatur sa më mirë transformimit dhe modernizimit të Forcave tona të Armatosura, por edhe për t’iu përgjigjur sfidave dhe zhvillimeve teknologjike që kërkon koha. Gjithashtu këto investime janë shprehje e vullnetit të palëkundur e Aleatit tonë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) të cilët hapën rrugën e krijimit të Komandës së Re si dhe ngritjen e kapaciteteve kibernetike me teknologji bashkëkohore, që mundëson sisteme të sigurta e të ndërveprueshme sipas standardeve të NATO-s.

Krahas zhvillimeve në fushën e teknologjisë, një aspekt shumë i rëndësishëm janë edhe trajnimet e avancuara të personelit tonë në fushën kibernetike dhe të ndërlidhjes. Ne e dimë tashmë se kërcënimi kibernetik kalon në radhë të parë nga njerëzit, pasi ato mbeten një sensor sigurie. Për të arritur një nivel të lartë sigurie ne kemi përmirësuar ndjeshëm aftësitë teknike dhe profesionale të personelit, përmirësimin e nivelit të ndërgjegjësimit dhe aftësitë në parandalimin dhe reagimin ndaj sulmeve. Forcat e Armatosura janë të integruara në strategjinë kombëtare të sigurisë kibernetike dhe kanë përforcuar masat e mbrojtjes pas incidenteve të mëparshme, duke rritur ndjeshëm gatishmërinë ndaj kërcënimeve të sofistikuara digjitale.

**Disa hapa se si ushtria shqiptare po përballon sfidat kibernetike janë:**

- Bashkëpunimi me NATO-n;
- Investime në infrastrukturë të sigurt;
- Trajnimi i personelit;
- Reagim e menjëhershëm ndaj sulmeve.

Gjithashtu dua të theksoj se, bazuar në Direktivën e Mbrojtjes, vizionin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe Planin Afatgjatë të zhvillimit për Forcat e Armatosura të Shqipërisë, një plan i ri i zhvillimit të Garnizonit të Komandës Kibernetike dhe Ndërlidhjes po i nënshtrohet procesit të hartimit dhe planifikimit. Ndërkohë që po rishikojmë projektet aktuale, po hartojmë projekte të reja të zhvillimit dhe modernizimit të mbrojtjes Kibernetike dhe Sistemeve TIK në MM dhe FA.

**Çfarë është Komanda Kibernetike dhe e Ndërlidhjes dhe çfarë funksioni ka në strukturën ushtarake?**

Komanda Kibernetike dhe e Ndërlidhjes është strukturë ushtarake brenda Forcave të Armatosura me kapacitete të përbashkëta kibernetike dhe ndërlidhjeje, me mision të garantojë një mjedis të sigurt kibernetik, të mbrojtë sistemet i informacionit dhe komunikimit në Ministrinë së Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura, sigurimin e kapaciteteve të ndërlidhjes për mbështetjen e Komandim Kontrollit në FA, ndërveprueshmëri me sistemet C2 të NATO-s, vendet partnere dhe institucionet kombëtare, trajnim të avancuar dhe certifikim të personelit



kibernetik dhe ndërlidhës, duke ofruar mbështetje për institucionet në rast të incidenteve kibernetike. Ajo luan një rol të rëndësishëm në transformimin teknologjik të Sistemeve dhe Platformave të implementuara në Forcat e Armatosura.

**Funksionet kryesore të Komandës Kibernetike dhe të Ndërlidhjes:**

- Mbrojtjen kibernetike të rrjeteve dhe infrastrukturës ushtarake;
- Sigurimin e komunikimit të qëndrueshëm dhe të sigurt për komandim dhe kontroll;
- Zhvillimin e projekteve të reja dhe aplikimin e teknologjive të avancuara në Sistemet TIK;
- Trajnimin e personelit në fushën kibernetike dhe të ndërlidhjes;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërinstitutional.

Gjithashtu, Komanda që unë drejtoj është një hallkë strategjike që ndihmon në ruajtjen e sovranitetit digjital që mbështet të gjithë zinxhirin komandues me sisteme të sigurta dhe të mbrojtura komunikimi.

**Cila është pesha e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes kibernetike?**

Bashkëpunimi ndërkombëtar në mbrojtjen kibernetike, është thelbësor për të përballuar natyrën globale dhe dinamike të kërcënimeve digjitale. Asnjë shtet nuk mund të mbrohet i vetëm, ndaj shkëmbimi i informacionit, ndihma teknike dhe strategjitë e përbashkëta bëhen elementë kyç të sigurisë kolektive. Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes kibernetike nuk është thjesht një dëshirë, është thelbësor për ruajtjen e sigurisë, mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe pengimin e aktiviteteve kibernetike dashakeqe. Duke pasur parasysh natyrën pa kufij të hapësirës kibernetike, asnjë komb i vetëm nuk mund ta mbrojë veten në mënyrë efektive në izolim.

Shtetet e aleancës, nëpërmjet Sistemeve Inteligjente të Paralajmërimit të Hershëm, ndajnë informacion në kohë reale në lidhje me kërcënimet në zhvillim, programet keqdashëse dhe modelet e sulmeve për t’u përgjigjur shpejt. Një pamje më e gjerë e kërcënimeve kibernetike globale e përmirëson aftësinë për të zbuluar dhe parashikuar sulme në shkallë të gjerë ose fushata të koordinuara. Vetëm përmes bashkëpunimit arrihet:

1. Mbrojtje dhe përgjigje e koordinuar, duke arritur reagim të shpejtë ndaj Incidenteve, ndërsa koordinimi shumëkombësh lejon rikuperim më të shpejtë nga incidentet kibernetike ndërkufitare. Aleatët mund të mbështesin njëri -tjetrin gjatë sulmeve kibernetike, duke ofruar eksperiencë dhe ekspertizë teknike ose infrastrukturore.

2. Përafrimi i ligjeve për krimin kibernetik dhe rregulloret dixhitale brenda shteteve të aleancës dhe jo vetëm, mundëson hetimin dhe ndjekjen penale ndërkufitare të kriminelëve kibernetikë. Standardet e përbashkëta të sigurisë kibernetike (p.sh., NIST, ISO) e promovojnë ndërveprimin dhe besimin midis sistemeve të NATO-s.

3. Paktet shumëpalëshe të mbrojtjes (si p.sh. Neni 5 i NATO-s) i dekurajojnë sulmet kibernetike të sponsorizuara nga shtetet jo miqësore, duke e rritur koston e agresionit. Shtetet, duke punuar së bashku përmes forumeve si OKB-ja ose BE-ja, kanë mundësinë për të vendosur norma për sjellje të përgjegjshme në hapësirën kibernetike.

4. Sektorët kritikë si financa, energjia, transporti dhe komunikimet janë të lidhur globalisht, kështu që edhe përgjigja duhet të jetë ndërshtetërore. Duke bashkëpunuar dhe duke u trajnuar bashkë, ne përmirësojmë rezistencën dhe njëkohësisht testojmë aftësitë e reagimit të koordinuar.

5. Shtetet e NATO-s të përparuara dhe me përvojë në fushën kibernetike mund të ndihmojnë të tjerët të ndërtojnë aftësitë e tyre të sigurisë kibernetike, duke krijuar një ekosistem dixhital global më të sigurt. Ndarja e praktikave dhe ekspertizave më të mira e ngre nivelin bazë të mbrojtjes kibernetike në nivel global.

6. Grupet kriminale dhe rrjetet terroriste, duke vepruar në hapësirën globale pa kufij, kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar të zbatimit të ligjit (p.sh. përmes INTERPOL-it, Europol-it).

Shkëmbimi i mjeteve teknike dhe të dhënave, ndihmon në identifikimin dhe gjurmimin e autorëve të krimit.

Pikat kryesore të bashkëpunimit ndërkombëtar janë të



përqendruara në shkëmbim të informacionit dhe inteligjencës kibernetike, me politika, standarde dhe stërvitje të koordinuara me qëllim reagimin e koordinuar dhe strategjinë globale për sigurinë kibernetike.

**Sa e rëndësishme është përfshirja e ekspertëve civilë në strukturat ushtarake teknologjike?**

Përfshirja e ekspertëve civilë në strukturat ushtarake teknologjike është shumë e rëndësishme për modernizimin, inovacionin dhe rritjen e sigurisë kibernetike. Ata sjellin ekspertizë të thelluar, përthithje më të shpejtë të njohurive rreth teknologjive të reja, duke ndihmuar në ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme.

**A parashikohet përdorimi i inteligjencës artificiale në strukturat mbrojtëse dhe si do të ndikojë ajo në eficiencën operacionale?**

Po, si në disa vende të NATO-s edhe në FARSH përdorimi i inteligjencës artificiale (IA) është parashikuar dhe ka nisur të zbatohet gjithnjë e më shumë. IA e rrit ndjeshëm efikasitetin operacional, duke përmirësuar analizën e të dhënave, reagimin ndaj sulmeve kibernetike, automatizimin e pajisjeve etj. Përdorimi i inteligjencës artificiale në mbrojtje do të çojë në vendimmarrje më të shpejtë si në zbulimin dhe neutralizimin e sulmeve kibernetike në mënyrë automatike.

Efektet e përdorimit të IA-së do të ndihen në eficiencën operacionale, duke siguruar saktësi më të lartë në zgjedhjen e objektivave, reagim më të shpejtë dhe ndërveprueshmëri më e madhe.

Pra, Inteligjenca artificiale është e ardhmja për operacionalitet më efikas dhe të integrueshëm. IA-ja përmirëson ndjeshëm analizën, reagimin, automatizimin dhe mbrojtjen, duke bërë që forcat e armatosura të kenë aftësi reaguese dhe fleksibilitet në menaxhimin e situatave. Për Shqipërinë dhe vende të tjera në zhvillim, integrimi i IA-së në mbrojtje përbën një mundësi strategjike për të kapërcyer kufizimet tradicionale dhe për të ngritur nivelin e sigurisë kombëtare.

**Si e garanton i ndërlidhjen dhe sigurinë e komunikimeve në kushte të një konflikti të mundshëm?**

Garantimi i ndërlidhjes dhe sigurisë së komunikimeve në kushte paqeje, krize dhe konflikti është thelbësor për funksionimin e suksesshëm të FARSH-së. Kjo arrihet përmes një kombinimi të teknologjisë së avancuar, masave mbrojtëse dhe përgatitjes njerëzore.

Ne kemi besim tek siguria e ndërlidhjes, pasi bazohemi tek përdorimi i sistemeve të koduara sipas standardeve të NATO-s, për të mbrojtur komunikimet. Sistemet rezervë me radio taktike dhe lidhje satelitore janë një mbështetje për vijueshmëri komunikimi. Ndarja e rrjeteve, trajnimi i personelit për operim në kushte të ndërprerjes së komunikimit, duke monitoruar 24/7, si dhe ndërveprueshmëria me NATO-n për operacione të sinkronizuara, janë garanci për punën tonë. Pra, përmes këtyre masave, KKN-ja siguron një ndërlidhje të pandërprerë, të mbrojtur dhe funksionale edhe në skenarët më sfidues të sigurisë kibernetike.

**Çfarë roli kanë teknologjitë si satelitët, dronët dhe rrjetet taktike në mbështetje të operacioneve ushtarake?**

Luftërat në zhvillim në Ukrainë dhe Iran, po tregojnë një model të ri të konfliktit të armatosur, që është lufta pa kontakt njerëzor. Teknologjitë moderne si satelitët, dronët dhe rrjetet taktike po bëhen gjithnjë edhe më përcaktuese për suksesin e operacioneve ushtarake moderne. Këto teknologji ofrojnë mundësi për zbulim strategjik, komunikim të sigurt dhe reagim të shpejtë, duke e transformuar fushën e betejës. Satelitët ofrojnë vëzhgim në kohë reale, komunikim global dhe koordinim të saktë për lëvizje dhe planifikim operacionesh. Dronët janë kryefjala e luftërave të ditëve tona, të cilët po mundësojnë zbulim, goditje precize dhe mbështetje logjistike, duke ulur rrezikun për jetën e ushtarëve. Pra, përdorimi i kombinuar i këtyre teknologjive krijon një fushë beteje të ndërlidhur dhe të koordinuar, duke mundësuar dominimin e situatës dhe sigurimin e suksesit në operacione ushtarake.

**Çfarë mesazhi do t’u jepnit të rinjve shqiptarë që dëshirojnë të kontribuojnë në mbrojtjen digjitale të vendit?**

Luftërat e sotme zhvillohen jo vetëm me armë, por edhe me kode dhe informacion, me tastierë dhe me maus. Mbrojtja



e vendit kërkon ekspertë të aftë në sigurinë kibernetike, inteligjencën artificiale dhe teknologjitë e avancuara. Studioi, specializohuni dhe kontribuoni në mbrojtjen e Shqipërisë, duke u angazhuar në strukturat e sigurisë kibernetike. Çdo kontribut, zbulimi qoftë një rresht kodi ose një algoritëm, është një akt patriotizmi modern.

**“Të rinj shqiptarë, Shqipëria ka nevojë për dijen dhe energjinë tuaj!” Asgjë nuk do t’iu bëjë juve më krenar se sa shërbimi ndaj atdheut.**

**CIS & Kapacitetet kibernetike**

Strukturat tona të komunikimit dhe informacionit (CIS) janë vlerësuar përmes proceseve të standardizuara dhe auditimeve teknike, duke rezultuar në përputhje të plotë me objektivat dhe kërkesat e kapaciteteve kibernetike të përcaktuara nga NATO. Kjo përputhshmëri reflekton një nivel të lartë të harmonizimit me standardet ndërkombëtare në fushën e sigurisë së informacionit, ndërveprueshmërisë dhe menaxhimit të sistemeve kritike. Në këtë kontekst, implementimi i politikave dhe protokolleve të sigurisë garanton mbrojtjen e të dhënave dhe të infrastrukturës nga kërcënimet e ndryshme kibernetike, duke përfshirë sulmet e avancuara dhe ndërhyrjet e paautorizuara.

Për më tepër, kjo përputhshmëri siguron që sistemet tona të jenë të afta të mbështesin operacione të sigurta, të qëndrueshme dhe të ndërveprueshme në të gjitha nivelet operacionale nga operacionet taktike në terren deri te koordinimi strategjik në mjedise shumëkombëshe. Arkitektura CIS është projektuar për të garantuar disponueshmëri të lartë, integritet të informacionit dhe konfidencialitet, duke mundësuar funksionim të pandërprerë edhe në kushte të vështira apo të degraduara operacionale.

Gjithashtu, përputhja me standardet e NATO-s lehtëson integrimin e sistemeve tona në rrjete dhe operacione të përbashkëta ndërkombëtare, duke rritur efikasitetin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit në kohë reale. Kjo aftësi ndërvepruese është thelbësore për përballimin e sfidave të sigurisë moderne, ku koordinimi dhe reagimi i shpejtë janë elementë kritikë për suksesin e misioneve.

Ky nivel i avancuar i përputhshmërisë dhe zhvillimit të kapaciteteve CIS dhe kibernetike jo vetëm që forcon sigurinë e brendshme të sistemeve tona, por edhe konsolidon rolin tonë si një partner i besueshëm dhe i aftë në kuadër të operacioneve dhe iniciativave të sigurisë kolektive.

**Mission partner environment (SATCOM)**

Mjedisi për partnerët e misionit (Mission Partner Environment MPE) përfaqëson një komponent kritik të arkitekturës moderne të komunikimit dhe bashkëpunimit operacional, i cili është plotësisht aktiv dhe funksional përmes kapaciteteve të avancuara satelitore (SATCOM). Ky mjedis mundëson shkëmbim të sigurt, të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të informacionit ndërmjet aktorëve të ndryshëm të përfshirë në operacione shumëkombëshe, duke garantuar një nivel të lartë të besueshmërisë dhe mbrojtjes së të dhënave. Përmes përdorimit të teknologjive të enkriptimit dhe protokolleve të standardizuara sipas kërkesave të NATO-s, sigurohet që informacioni i ndarë të mbetet i mbrojtur nga ndërhyrjet e paautorizuara dhe kërcënimet kibernetike.

Për më tepër, funksionaliteti i MPE-së përmes SATCOM eliminon kufizimet gjeografike dhe infrastrukturore, duke mundësuar lidhje të pandërprerë edhe në zona të largëta ose në kushte operacionale të vështira. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për operacionet në terrene të izoluar, ku infrastruktura tokësore e komunikimit mund të jetë e kufizuar ose e dëmtuar. Në këtë mënyrë, MPE-ja kontribuon në ruajtjen e një rrjedhe të vazhdueshme informacioni, e cila është

thelbësore për koordinimin efektiv dhe reagimin në kohë reale ndaj situatave dinamike.

Ky kapacitet rrit ndjeshëm nivelin e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke lehtësuar integrimin e forcave dhe strukturave nga vende të ndryshme në një mjedis të përbashkët operacional. Përmes MPE-së, aktorët e ndryshëm mund të ndajnë të dhëna, plane operative dhe informacione kritike në kohë reale, duke përmirësuar ndjeshëm ndërgjegjësimin situacional dhe cilësinë e vendimmarrjes. Kjo ndërveprueshmëri është një element kyç për suksesin e operacioneve të përbashkëta, ku koordinimi i saktë dhe i shpejtë është thelbësor.

Implementimi dhe funksionimi efektiv i Mission Partner Environment përmes SATCOM jo vetëm që forcon kapacitetet tona teknologjike dhe operacionale, por gjithashtu konsolidon rolin tonë si një partner i besueshëm në mjediset shumëkombëshe. Ky sistem përfaqëson një investim strategjik në sigurinë, fleksibilitetin dhe efikasitetin e operacioneve moderne.

**Lidhja e bazave dhe njësive**

Të gjitha bazat dhe njësitë tona janë të ndërlidhura përmes një infrastrukture të integruar dhe të avancuar komunikimi, e cila kombinon teknologji të ndryshme si fibrë optike, lidhje mikrovalore dhe komunikime satelitore (SATCOM). Kjo qasje e shumëfishtë siguron një rrjet të qëndrueshëm dhe fleksibël, i aftë të përballojë kërkesat e larta operacionale dhe të adaptohet në mënyrë dinamike ndaj kushteve të ndryshme të funksionimit. Integrimi i këtyre teknologjive krijon një arkitekturë të balancuar që shfrytëzon avantazhet e secilës formë komunikimi, duke optimizuar shpejtësinë, kapacitetin dhe mbulimin gjeografik.

Fibra optike përbën shtyllën kryesore të infrastrukturës, duke ofruar transmetim të shpejtë dhe me kapacitet të lartë të të dhënave në distanca të gjata, me nivele minimale të vonesës dhe ndërhyrjeve. Ndërkohë, lidhjet mikrovalore shërbejnë si një alternativë efikase për komunikim në zona ku infrastruktura fizike është e kufizuar ose ku kërkohet vendosje e shpejtë e rrjeteve. Komunikimet satelitore plotësojnë këtë ekosistem, duke garantuar lidhje të qëndrueshme edhe në zona të largëta, të izoluar ose në kushte operacionale të vështira, ku format e tjera të komunikimit mund të mos jenë të disponueshme.

Kjo arkitekturë e integruar siguron një nivel të lartë redundance, duke mundësuar që në rast të ndërprerjes së një kanali komunikimi, trafiku të ridrejtohet automatikisht përmes kanaleve alternative pa ndërprerje të ndjeshme të shërbimit. Si rezultat, garantohet vazhdimësia operacionale edhe në kushte të degraduara, siç janë situatat emergjente, sulmet kibernetike apo dëmtimet fizike të infrastrukturës. Ky nivel i qëndrueshmërisë është thelbësor për mbështetjen e operacioneve kritike, ku komunikimi i pandërprerë dhe i besueshëm është një faktor kyç për suksesin e misionit.

Për më tepër, ndërlidhja e plotë e bazave dhe njësive rrit ndjeshëm ndërgjegjësimin situacional dhe përmirëson koordinimin ndërmjet strukturave të ndryshme. Ajo mundëson shkëmbim të shpejtë dhe të sigurt të informacionit, duke lehtësuar vendimmarrjen në kohë reale dhe duke rritur efikasitetin operacional në mjedise komplekse dhe dinamike.

Infrastruktura e integruar e komunikimit përfaqëson një element strategjik në garantimin e funksionimit të pandërprerë të sistemeve tona, duke ofruar një bazë të fortë për operacione të sigurta, të qëndrueshme dhe të ndërveprueshme në çdo nivel operacional.

**Cloud hibrid i ndërveprueshëm me NATO-n**

Është duke u punuar për të implementuar një arkitekturë cloud hibrid që përfaqëson një nga komponentët kryesorë të modernizimit të infrastrukturës sonë digjitale dhe të

kapaciteteve operacionale. Ky model kombinon burimet e brendshme me shërbimet cloud, duke krijuar një mjedis fleksibël, të shkallëzueshëm dhe të sigurt për menaxhimin e të dhënave dhe aplikacioneve. Në përputhje me standardet dhe politikat e NATO-s, ky cloud duhet të mbështesë njëkohësisht rrjetet e paklasifikuara dhe ato të klasifikuara, duke siguruar ndarje të qartë dhe të kontrolluar të niveleve të sigurisë për informacionin.

Implementimi i këtij sistemi mundëson menaxhim të avancuar të të dhënave, duke garantuar konfidencialitet, integritet dhe disponueshmëri në përputhje me kërkesat më të larta të sigurisë. Përmes përdorimit të mekanizmave të fortë të enkriptimit, autentifikimit shumë-faktorësh dhe kontrollit të aksesit të bazuar në role, sigurohet që vetëm përdoruesit e autorizuar të kenë akses në informacionin kritik. Gjithashtu, monitorimi i vazhdueshëm dhe sistemet e zbulimit të kërcënimeve kontribuojnë në identifikimin dhe parandalimin e incidenteve kibernetike në kohë reale.

Një nga avantazhet kryesore të cloud-it hibrid është aftësia për të mundësuar shkëmbim të sigurt dhe efikas të të dhënave ndërmjet strukturave të ndryshme kombëtare dhe partnerëve ndërkombëtarë. Kjo ndërveprueshmëri është thelbësore për operacionet shumëkombëshe, ku kërkohet koordinim i ngushtë dhe ndarje e shpejtë e informacionit. Përmes standardizimit të proceseve dhe protokolleve sipas kërkesave të NATO-s, arrihet integrim i plotë në mjediset operacionale të përbashkëta, duke rritur efektivitetin dhe koherencën e veprimeve.

Për më tepër, arkitektura cloud hibrid ofron fleksibilitet operacional dhe optimizim të burimeve, duke lejuar shpërndarjen dinamike të ngarkesave të punës dhe përshtatjen ndaj nevojave të ndryshme operacionale. Kjo e bën sistemin më rezistent ndaj ndërprerjeve dhe më të aftë për të përballuar kërkesat në rritje për përpunim dhe ruajtje të të dhënave.

**Ushtrimet kibernetike**

Jemi në një proces progresiv dhe të strukturuar zhvillimi në fushën e ushtrimeve kibernetike, i cili fillon me pjesëmarrjen aktive në ushtrime ndërkombëtare, vijon me angazhimin në bashkë-organizimin e tyre dhe synon në fazat e ardhshme organizimin e plotë të ushtrimeve në nivel kombëtar dhe shumëkombësh. Kjo qasje graduale mundëson ndërtimin e kapaciteteve në mënyrë të qëndrueshme, duke përfutur nga eksperiencat dhe praktikat më të mira të partnerëve ndërkombëtarë, veçanërisht në kuadër të bashkëpunimit me NATO-n.

Pjesëmarrja në këto ushtrime krijon mundësi për testimin e sistemeve, procedurave dhe reagimit operacional në skenarë realistë që simulojnë kërcënimet të avancuara kibernetike. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, identifikohen dobësitë potenciale dhe përmirësohen mekanizmat e mbrojtjes, duke rritur në mënyrë të drejtpërdrejtë gatishmërinë dhe reziliencën institucionale. Kalimi drejt bashkë-organizimit dhe më pas drejt organizimit të plotë të ushtrimeve përforcon më tej aftësitë tona planifikuese, koordinuese dhe drejtuese në këtë fushë kritike.

Kjo qasje kontribuon jo vetëm në zhvillimin teknik dhe operacional të kapaciteteve kibernetike, por edhe në forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe ndërkombëtar. Përmes ushtrimeve të përbashkëta, rritet ndërveprueshmëria, përmirësohet shkëmbimi i informacionit dhe harmonizohen procedurat sipas standardeve të sigurisë kolektive. Në këtë mënyrë, konsolidohet roli ynë si një kontribuues aktiv dhe i besueshëm në arkitekturën e sigurisë kibernetike, duke përforcuar aftësinë për t’u përballur me sfidat gjithnjë e më komplekse të mjedisit digjital.

**Trajnimi dhe certifikimi i personelit**

Personeli i fushës së IT-së dhe sigurisë kibernetike është i përfshirë në mënyrë sistematike në programe të strukturizuara trajnimi dhe certifikimi, të cilat janë të harmonizuara me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e NATO-s. Këto programe përfshijnë një gamë të gjerë tematikash, duke filluar nga bazat e sigurisë së informacionit dhe administrimit të rrjeteve, deri te menaxhimi i incidenteve kibernetike, analiza e kërcënimeve dhe mbrojtja ndaj sulmeve të avancuara. Qasja e ndjekur synon jo vetëm përvetësimin e njohurive teorike, por edhe zhvillimin e aftësive praktike përmes simulimeve, laboratorëve teknikë dhe pjesëmarrjes në ushtrime reale.

Procesi i certifikimit luan një rol kyç në validimin e kompetencave profesionale të personelit, duke siguruar që aftësitë dhe njohuritë e tyre të jenë në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare. Certifikimet e njohura globalisht kontribuojnë në rritjen e besueshmërisë dhe profesionalizmit të staftit, si dhe në garantimin e një niveli të lartë të cilësisë në menaxhimin dhe mbrojtjen e sistemeve kritike të informacionit.

Për më tepër, ky proces i vazhdueshëm trajnimi dhe certifikimi është thelbësor për t’u përballur me natyrën dinamike dhe në evoluim të kërcënimeve kibernetike. Duke qenë se teknologjitë dhe metodat e sulmit ndryshojnë vazhdimisht, përditësimi i njohurive dhe aftësive të personelit është një domosdoshmëri strategjike. Në këtë kuadër, investimi në zhvillimin profesional të staftit siguron një forcë punëtore të përgatitur, fleksibile dhe të aftë për të reaguar në mënyrë efektive ndaj incidenteve kibernetike.

Gjithashtu, këto programe kontribuojnë në ndërtimin e një kulture organizative të orientuar drejt sigurisë, ku ndërgjegjësimi dhe përgjegjësia për mbrojtjen e informacionit janë të integruara në të gjitha nivelet. Përmes këtij angazhimi të vazhdueshëm, jo vetëm që përforcohen kapacitetet teknike individuale, por edhe rritet reziliencia e përgjithshme institucionale ndaj sfidave të sigurisë digjitale.

Trajnimi dhe certifikimi i personelit përbëjnë një shtyllë themelore për garantimin e sigurisë kibernetike dhe efikasitetit operacional, duke siguruar që organizata të jetë e pajisur me ekspertizën e nevojshme për të përballuar me sukses mjedisin kompleks dhe gjithnjë në ndryshim të kërcënimeve moderne.



Prof. Dr. Elidjana Canaj

**Një dokument i rrallë historik sjell për lexuesin e gazetës “Ushtria” kujtime nga ditët e luftës, organizimi i një formacioni ushtarak dhe përjetimet e një luftëtari të rreshtuar në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare**

Në fondin e kujtesës historike dhe ushtarake të një vendi, një vlerë të veçantë kanë dokumentet e shkruara nga vetë protagonistët e ngjarjeve. Ato nuk janë vetëm kronika të ftohta të zhvillimeve, por dëshmi të gjalla që sjellin atmosferën, vështirësitë, sakrificat dhe përjetimet njerëzore të një periudhe të rëndësishme historike.

Një dokument i tillë është edhe ditari i partizanit **Murat Abazi**, i cili përmes shënimeve të tij të përditshme ka fiksuar momente nga procesi i krijimit, organizimit dhe veprimtarisë luftarake të **Brigadës XV Sulmuese** gjatë vitit 1944.

Ky ditar, i ruajtur me kujdes ndër vite dhe i sjellë për botim për lexuesit e gazetës “Ushtria” nga vajza e tij, **Prof. Dr. Elidjana Canaj**, përbën një dëshmi me vlerë të veçantë për historinë ushtarake shqiptare.

Ai sjell zërin e një pjesëmarrësi të drejtpërdrejtë, i cili nuk shkruan nga largësia e kohës, por nga terreni i luftës, mes lëvizjeve, përballjeve dhe sfidave të përditshme.

#### Nga shënimet personale te dokumenti historik

Ditarët e luftës kanë një veçori të veçantë: ata ndërthurin historinë e madhe me historinë e njerëzve.

Në faqet e ditarit të Murat Abazit shfaqet realiteti i një formacioni ushtarak në krijim e sipër: lëvizjet e batalioneve, përgatitjet, organizimi i brendshëm, lidhjet mes njërive dhe përballjet në terren.

Muaji qershor 1944 paraqitet si një periudhë vendimtare. Në kushtet e zhvillimeve të mëdha ushtarake të Luftës së Dytë Botërore, forcat partizane organizohen dhe krijojnë formacione të reja luftarake.

Në këtë kuadër, ditari përshkruan rrugën drejt krijimit të Brigadës XV Sulmuese, duke evidentuar lëvizjet e batalioneve dhe përpjekjet për bashkimin e tyre në një strukturë më të organizuar.

Më 29 qershor 1944, forcat mbledhen për formimin e brigadës në malin e Protopapës, tek Kroi i Buzos. Situata luftarake nuk lejonte ceremoni të gjata dhe organizimi vazhdoi në kushtet e veprimeve të drejtpërdrejta.

Ky detaj e bën dokumentin edhe më domethënës: një formacion ushtarak lindte jo në kushte normale paqeje, por në mes të përballjes.

#### Organizimi ushtarak dhe kujdesi për çdo luftëtar


Një ndër vlerat më të rëndësishme të ditarit është pasqyrimi i organizimit të brendshëm të njërive.

Në të janë ruajtur të dhëna për strukturën e kompanive dhe skuadrave, emrat e luftëtarëve dhe gjendjen e armatimit.

Këto shënime tregojnë se, krahas veprimeve luftarake, ekzistonte një përpjekje e vazhdueshme për administrimin dhe organizimin e forcave.

# Një ditar nga lufta që ruan zërin e një brezi

## Dëshmia e partizanit Murat Abazi mbi krijimin dhe rrugëtimin e Brigadës XV Sulmuese



Evidentimi i armëve, municioneve, pajisjeve dhe nevojave të luftëtarëve dëshmon rëndësinë që kishte organizimi edhe në kushtet e një lufte partizane.

Pas çdo emri të shënuar në ditar qëndron një histori personale: një njeri që kishte marrë përsipër barrën e luftës, me të gjitha vështirësitë dhe sakrificat e saj.

#### Brigada XV Sulmuese në betejë

Pas krijimit të saj, Brigada XV Sulmuese hyri në veprime luftarake. Ditari i Murat Abazit përshkruan lëvizjet dhe përballjet gjatë muajve korrik, gusht dhe shtator 1944.

Nga shënimet dalin në pah marshimet e gjata, netët në terren, mungesat, lodhja fizike, por edhe organizimi dhe vendosmëria e një formacioni që ishte në lëvizje të vazhdueshme.

Në korrik përshkruhen veprimet në zonat e Gorës, Mokrës dhe krahinave përreth, ndërsa më 25 korrik shënohet inaugurimi i Brigadës XV Sulmuese në Qafën e Panjës.

Më tej, ditari vijon me përshkrimin e aksioneve, zhvendosjeve dhe përballjeve të ndryshme deri në muajt e fundit të vitit 1944.

Këto faqe sjellin jo vetëm historinë e një njësie ushtarake, por edhe përvojën njerëzore të njerëzve që e përbënin atë.

#### Vlera e kujtesës së shkruar

Dokumente të tilla kanë një rëndësi të veçantë për historinë ushtarake. Ato plotësojnë tablonë e përgjithshme të ngjarjeve, duke sjellë zërin e atyre që ishin pjesë e tyre.

Ditarët nuk zëvendësojnë dokumentet zyrtare, por i japin historisë një dimension tjetër: atë njerëzor.

Nëpërmjet shënimeve të Murat Abazit shohim jo vetëm lëvizjet dhe betejat, por edhe jetën e përditshme të një formacioni ushtarak, marrëdhëniet mes njerëzve, vështirësitë dhe përkushtimin e tyre.

#### Një trashëgimi për brezat

Sjellja në dritë e këtij ditarit është një kontribut në ruajtjen e kujtesës historike.

Falë kujdesit të familjes dhe veçanërisht Prof. Dr. Elidjana Canaj, një dokument i krijuar në kushtet e luftës vazhdon të komunikojë me brezat e sotëm. Historia ushtarake nuk përbëhet vetëm nga data dhe betejat. Ajo ndërtohet edhe nga rrëfimet e njerëzve që jetuan ato momente.

**Dhe pikërisht për këtë arsye, ditari i Murat Abazit mbetet një dëshmi me vlerë: një zë nga e kaluara që na ndihmon të kuptojmë më mirë sakrificat, përpjekjet dhe realitetin e një prej periudhave më të rëndësishme të historisë sonë.**



# FADIL TOÇI: Ushtaraku që komandoi formacione të mëdha të Ushtrisë Shqiptare dhe la gjurmë në historinë e Mbrojtjes Kundërajrore



## Një jetë kushtuar uniformës, dijes ushtarake dhe përgatitjes së brezave të rinj të oficerëve

Në historinë e Forcave të Armatosura Shqiptare ka figura që nuk maten vetëm me detyrat që kanë mbajtur, por me gjurmën që kanë lënë në zhvillimin e ushtrisë, në përgatitjen e kuadrove dhe në kulturën profesionale ushtarake. Një prej këtyre personaliteteve është gjeneral Fadil Toçi, një nga ushtarakët më të spikatur të artilerisë kundërajrore shqiptare, komandant i formacioneve të mëdha dhe një figurë me përgatitje të gjerë profesionale e shkencore.

Fadil Toçi lindi më 5 korrik 1937, në Kovashicë të Peshkopisë. Rrugën drejt profesionit të ushtarakut e nisi që i ri, në vitin 1950, kur filloi studimet në Shkollën Ushtarake “Skënderbej”. Ishte një periudhë formimi që do të përcaktonte gjithë jetën e tij të ardhshme.

Pas përfundimit të kësaj shkolle, vazhdoi studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, në specialitetin e Artilerisë Kundërajrore. Rezultatet e shkëlqyera gjatë studimeve i dhanë mundësinë të merrte gradën e togerit menjëherë pas diplomimit. Një tregues i vlerësimit për përgatitjen e tij ishte edhe fakti që fjalën përshëndetëse në ceremoninë e diplomimit të oficerëve të rinj e mbajti pikërisht toger Fadil Toçi.

## Një karrierë e ndërtuar mbi dije, përkushtim dhe aftësi komanduese

Karriera e tij ushtarake u zhvillua me një ritëm të shpejtë, e mbështetur në përgatitjen profesionale, aftësitë drejtuese dhe pasionin për shkencën ushtarake.

Në vitin 1956 shërbeu si komandant toge në Tiranë. Vetëm dy vite më vonë, në vitin 1958, mori detyrën e komandantit të baterisë kundërajrore 100 mm në Karaburun. Në vitin 1959 u emërua shef shtabi i grupit kundërajror në Karaburun, ndërsa në vitin 1960 u bë Shef Shtabi i Regjimentit Kundërajror në Vlorë.

Në vitin 1962 drejtoi grupin kundërajror në Cërrik, duke vazhduar të dëshmonte aftësi të larta organizative dhe komanduese.

Formimi i tij nuk u ndal vetëm te përvoja praktike. Ai investoi vazhdimisht në arsimimin ushtarak dhe shkencor. Në vitet 1964-1966 përfundoi studimet e larta në Akademinë Ushtarake “Mehmet Shehu”, ndërsa më vonë, në vitet 1968-1974, kreu studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, dega Matematikë.

Ky kombinim mes përgatitjes ushtarake dhe asaj shkencore e bëri një nga ushtarakët më të kompletuar të kohës së tij.

## Komandant i Mbrojtjes Kundërajrore dhe i Grupimit të 8-të Operativ

Në vitin 1972, Fadil Toçi emërohet në detyrën e lartë të Komandantit të Artilerisë Kundërajrore të Shqipërisë. Në këtë funksion ai dha një kontribut të rëndësishëm në organizimin, stërvitjen dhe përmirësimin e gatishmërisë luftarake të kësaj arme.

Në vitin 1973, gjatë muajve tetor-dhjetor, ai ishte një prej nëntë ushtarakëve shqiptarë të dërguar për eksperiencë në luftën e Vietnamit. Kjo përvojë kishte rëndësi të veçantë, pasi teknika dhe armatimi kundërajror i përdorur në atë konflikt ishte i ngjashëm me atë që dispononte Shqipëria në atë periudhë.

Kulmin e karrierës së tij ushtarake e arriti në vitin 1975, kur u emërua Komandant i Grupimit të 8-të Operativ në Elbasan.

Në prezantimin e tij në këtë detyrë, Kryeministri i kohës Mehmet Shehu e cilësoi shkurt, por me domethënie të thellë: “Prezantoj në detyrën e komandantit të Grupimit shkencëtarin ushtarak, shokun Fadil Toçi”.

Ky vlerësim lidhej me formimin e tij të gjerë dhe aftësinë për të ndërthurur dijen teorike me praktikën e komandimit.

Grupimi i 8-të Operativ ishte një nga formacionet më të mëdha të Ushtrisë Shqiptare. Ai përfshinte njësi këmbësorie, artilerie, tankiste, kundërajrore, ndërlidhjeje, xheniere, kimie etj. Shtirja e tij gjeografike përfshinte një territor të gjerë nga Elbasani, Librazhdi, Gramshi, Pogradeci, Lushnja, Fieri, Mallakastër, Berati, Skrapari, deri pranë Përmetit dhe Vlorës.

Drejtimi i këtij formacioni kërkonte aftësi të veçanta strategjike, organizim të lartë dhe përgjegjësi të jashtëzakonshme. Fadil Toçi i përmbushi këto detyra me profesionalizëm dhe përkushtim.

## Një ushtarak i respektuar dhe një pedagog i brezave të rinj

Në vitin 1982, karriera e tij në nivelet e larta komanduese u ndërpre. Ai u largua nga detyrat e larta dhe vazhdoi veprimtarinë si punonjës shkencor dhe pedagog në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm.

Në vitin 1992 doli në pension, por dashuria për dijen dhe profesionin ushtarak e mbajti përsëri pranë brezave të rinj. Nga viti 1993 deri në vitin 1998 vijoi të punojë si pedagog në Akademinë e Mbrojtjes.

Për shumë ushtarakë të rinj të artilerisë kundërajrore, Fadil Toçi ishte një figurë frymëzuese. Ai njihej për dijen e thellë, pasionin për profesionin dhe aftësinë për të shpjeguar me qartësi edhe çështjet më të ndërlikuara të teknikës dhe taktikës ushtarake.

## Një emër që mbetet në kujtesën e ushtrisë

Fadil Toçi nuk ishte vetëm komandant. Ai ishte edhe një njeri i dijes dhe i kulturës ushtarake. Një kontribut të veçantë dha edhe në dokumentimin e historisë së Mbrojtjes Kundërajrore të Shqipërisë.

Ai shkroi parathënien e librit “Mbrojtja Kundërajrore e Shqipërisë”, botuar më 20 qershor 2012, një vepër që u prit me interes nga lexuesit brenda dhe jashtë vendit.

Për ata që e njohën, Fadil Toçi mbetet një ushtarak model: i përgatitur, i përkushtuar, kërkues ndaj vetes dhe të tjerëve, një profesionist që e lidhi jetën me uniformën dhe shërbimin ndaj vendit.

Ai u nda nga jeta, më 16 dhjetor 2020, por figura e tij vazhdon të jetojë përmes kujtimeve të bashkëpunëtorëve, kolegëve dhe brezave të ushtarakëve që u formuan nën ndikimin e tij.

Më 1 korrik 2026, në 95-vjetorin e krijimit të Mbrojtjes Kundërajrore të Shqipërisë, kujtimi i tij merr një domethënie të veçantë. Është një rast për të nderuar një nga kontribuuesit më të rëndësishëm të kësaj arme dhe për të rikujtuar se njerëzit që i kanë shërbyer me përkushtim ushtrisë nuk duhet të mbulohen nga pluhuri i harresës.

Sepse emra të tillë nuk mbeten vetëm në histori. Ata mbeten në kujtesën e ushtrisë dhe të kombit.

Me rastin e 95-vjetorit të krijimit të Mbrojtjes Kundërajrore

të Shqipërisë, redaksia e gazetës “Ushtria” përcjell urimet më të mira për të gjithë brezat e ushtarakëve që kanë shërbyer në këtë armë të rëndësishme të Forcave të Armatosura.

Ky përvjetor është një moment reflektimi dhe mirënjohjeje për punën, përkushtimin dhe sakrificat e mijëra ushtarakëve që ndër vite kanë kontribuar në zhvillimin, përgatitjen dhe modernizimin e Mbrojtjes Kundërajrore.

Një nderim i veçantë i takon figurave të spikatura që lanë gjurmë në historinë e kësaj arme, ndër të cilët është edhe komandanti dhe ushtaraku madhor **Fadil Toçi**, një personalitet me vlera të larta profesionale, shkencore dhe njerëzore.

Ai mbetet simbol i përgatitjes së thellë, i përgjegjësisë së komandës dhe i dashurisë për profesionin ushtarak. Kontributi i tij në drejtimin e formacioneve të mëdha, në zhvillimin e artilerisë kundërajrore dhe në edukimin e brezave të rinj të oficerëve përbën një trashëgimi të çmuar për Forcat e Armatosura Shqiptare.

Në këtë ditë përkujtimore, shprehim respektin dhe mirënjohjen për të gjithë ata që i shërbyen kësaj arme, për ata që vazhdojnë ta mbajnë gjallë traditën e saj dhe për emrat që me punën e tyre janë bërë pjesë e historisë ushtarake shqiptare.

**Nderim dhe mirënjohje për të gjithë kontribuuesit e Mbrojtjes Kundërajrore!**

# GJUHA ARBËRESHE, NJË PASURI QË KËRKON TË JETOJË PËRTEJ KUJTESËS

Gjuha arbëreshe është një nga dëshmitë më të çmuara të vazhdimësisë historike, kulturore dhe shpirtërore të shqiptarëve përtej Adriatikut. Ajo nuk është vetëm një mënyrë komunikimi, por një kujtesë e gjallë e një historie që ka kaluar shekuj, duke ruajtur brenda saj fjalën, traditën, këngën, zakonet dhe ndjenjën e përkatësisë.

Në këtë përpjekje të vazhdueshme për ruajtjen dhe promovimin e kësaj pasurie kombëtare, një figurë e veçantë është edhe Cettina Mazzei, nga komuniteti arbëresh i Caraffa-s në Kalabri të Italisë. Ajo është mësuese, piktoe, veprimtare e shquar dhe promovuese e kulturës arbëreshe. Me përkushtimin e saj të vazhdueshëm, ajo është bërë një nga zërat më të dashur të komunitetit arbëresh dhe një ambasadore e vlerave shqiptare në Itali.

Cettina Mazzei përfaqëson modelin e njeriut që nuk dorëzohet përballë sfidave të kohës. Me dashuri për gjuhën, kulturën dhe historinë e paraardhësve të saj, ajo dëshmon se identiteti nuk është vetëm një trashëgimi e marrë nga e kaluara, por një përgjegjësi që duhet t'u përcillet brezave të rinj.

## Arbërishtja, kujtesë historike dhe pasuri e gjallë

Siç thekson Cettina Mazzei, "gjuha" në arbërisht do të thotë "gjuhë", por në kuptimin më të thellë ajo është shumë më tepër se një fjalë. Është shenjë e vazhdimësisë kulturore të një komuniteti që për gati gjashtë shekuj ka ruajtur lidhjen me origjinën e vet.

Arbëreshët mbërritën në Italinë e Jugut gjatë shekujve XV-XVI, si pasojë e lëvizjeve të popullsisë shqiptare nga trojet ballkanike për shkak të përparimit osman. Ata u vendosën kryesisht në Kalabri dhe Sicili, duke krijuar komunitete ku ruajtën gjuhën, traditat dhe kujtesën e prejardhjes.

Për shumë kohë, kjo trashëgimi u mbajt gjallë përmes familjes, jetës komunitare dhe transmetimit brez pas brezi. Por sot realiteti është më sfidues. Përdorimi i përditshëm i arbërishtes është duke u zvogëluar dhe sidomos brezat e rinj po largohen gradualisht nga përdorimi i saj aktiv.

Rreziku nuk lidhet vetëm me humbjen e një gjuhe, por me humbjen e një mënyre të veçantë të menduarit, të një bote vlerash dhe të një kujtese kolektive. Çdo gjuhë që zhduket merr me vete një pjesë të historisë njerëzore.

## Mendim dhe reflektim

Ruajtja e arbërishtes dhe e veçorive kulturore arbëreshe është një detyrim ndaj historisë dhe ndaj brezave të ardhshëm. Ato janë dëshmi të vlerave etnike dhe atdhetare shqiptare, dëshmi të pasurisë dhe evolucionit të identitetit tonë kombëtar, por edhe një urë komunikimi mes shqiptarëve këtej dhe përtej Adriatikut.

Arbëreshët përbëjnë një model të jashtëzakonshëm historik të ruajtjes dhe përshtatjes së vlerave identitare. Ata kanë ditur të integrohen në shoqërinë ku jetojnë, të bashkëjetojnë për shekuj me kulturën vendase, pa humbur

***Cettina Mazzei, mësuese, piktoe dhe veprimtare e palodhur e kulturës arbëreshe nga Caraffa di Catanzaro, Kalabri, një zë i fuqishëm në mbrojtje të gjuhës dhe identitetit arbëresh***



rrënjët dhe trashëgiminë e tyre.

Ata nuk ndihen të huaj në vendin ku kanë ndërtuar jetën e tyre, por njëkohësisht ruajnë me krenari gjithçka arbëreshe dhe shqiptare që kanë trashëguar nga të parët.

Ky proces kërkon më shumë vëmendje dhe mbështetje nga institucionet shtetërore, arsimore, shkencore dhe kulturore, si në Shqipëri dhe Kosovë, ashtu edhe në Itali. Ruajtja e

kësaj trashëgimie nuk mund të jetë vetëm përgjegjësi e familjeve arbëreshe apo e nismave individuale. Ajo kërkon një angazhim të përbashkët, afatgjatë dhe të organizuar.

Me rëndësi të veçantë janë kontaktet e vazhdueshme mes shqiptarëve dhe arbëreshëve, projektet kulturore, arsimore dhe shkencore, si dhe krijimi i mundësive që kjo pasuri të mos mbetet vetëm një kujtim historik, por të vazhdojë të jetë pjesë e jetës së përditshme.

## Mesazhi i Cettina Mazzeit për gjuhën

Një nga mesazhet më të rëndësishme që kam dëgjuar nga Cettina Mazzei lidhet me zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës arbëreshe. Sipas saj, gjuha ka procesin e vet dinamik të zhvillimit. Ajo ndryshon, pasurohet dhe përshtatet si mjet komunikimi mes njerëzve. Është e natyrshme që në përdorimin e përditshëm të mos gjenden gjithmonë të gjitha fjalët e nevojshme në fondin leksikor të arbërishtes së folur.

Por kjo mungesë nuk duhet të zgjidhet gjithmonë duke marrë fjalë nga gjuhët e tjera, veçanërisht nga italishtja. Pasurimi i arbërishtes duhet të mbështetet te burimi i saj më i afërt dhe më i natyrshëm: gjuha shqipe.

Leksiku arbëresh mund të zhvillohet duke u ushqyer nga pasuria e shqipes, duke ruajtur njëkohësisht veçantinë dhe identitetin e tij historik.

Gjuha e folur dhe e shkruar nuk është vetëm një simbol i identitetit tonë etnik. Ajo duhet të jetë një mjet funksional i jetës së përditshme, i komunikimit shoqëror, profesional dhe kulturor.

Sot, mbijetesa e arbërishtes varet nga brezat e tanishëm. Paraardhësit e sollën këtë gjuhë përtej detit si një amanet të çmuar. Detyra jonë është që ky amanet të mos mbetet vetëm në kujtesën e historisë, por të vazhdojë të jetojë në fjalën e njerëzve.

***Sepse çdo gjuhë e shpëtuar është një pjesë e njerëzimit që vazhdon të jetojë.***



# 1 Korrik 1931: Një armë, një histori, një mision – Artileria Kundërajrore e Forcave të Armatosura Shqiptare



Eduard Demo

**Një histori 95-vjeçare përkushtimi, profesionalizmi dhe mbrojtjeje të hapësirës ajrore shqiptare**

**Nga modernizimi i Ushtrisë Shqiptare në periudhën e Mbretërisë së Ahmet Zogut, deri te zhvillimi i saj si një nga komponentët kryesorë të sistemit të mbrojtjes kombëtare, Arma e Kundërajrorit mbetet një kapitull i rëndësishëm në historinë e Forcave të Armatosura Shqiptare.**

Më 1 korrik 1931, u krijua si armë e veçantë **Arma e Kundërajrorit në Ushtrinë Shqiptare**, në kuadër të përpjekjeve të shtetit shqiptar për modernizimin e strukturave ushtarake gjatë periudhës së Mbretërisë së Ahmet Zogut. Krijimi i saj u bë me vendim të Ministrisë së Luftës, nën autoritetin e Mbretit Zog, duke shënuar një hap të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse të vendit.

Nevoja për krijimin e kësaj arme lidhej drejtpërdrejt me zhvillimin e aviacionit ushtarak dhe domosdoshmërinë e mbrojtjes së qendrave të rëndësishme strategjike, si Tirana, Durrësi dhe Vlora, si dhe aeroporteve, porteve detare dhe objekteve me rëndësi kombëtare.

Në fazat e para të organizimit, një rol të rëndësishëm luajtën misionet dhe instruktorët ushtarakë italianë, të cilët kontribuan në trajnimin teknik të personelit shqiptar dhe në organizimin fillestar të reparteve kundërajrore. Furnizimi me mitraloza kundërajrorë dhe topa të lehtë kundërajrorë krijoi bazën e parë teknike të kësaj arme.

Oficerët shqiptarë të artilerisë u specializuan gradualisht në këtë fushë dhe morën drejtimin e njërive të krijuara. Ndër figurat e rëndësishme të kësaj periudhe përmenden:

- **Kolonel Ali Riza Kolonja**, artiljer karriere dhe një nga figurat e rëndësishme në organizimin e artilerisë moderne shqiptare, ku përfshihej edhe komponenti kundërajror.
- **Major (më pas nënkolonel) Xhemal Staravecka**, oficer profesionist i artilerisë, i cili mbajti detyra drejtuese në struktura artilerie me funksione kundërajrore.
- **Kapiten/Major Hysni Dema**, një nga oficerët e trajnuar për përdorimin dhe drejtimin e baterive kundërajrore në mbrojtje të objekteve strategjike.

Në periudhën 1933–1938, disa specialistë italianë patën rol teknik dhe instruktues në përgatitjen e reparteve të para, pa zëvendësuar komandën shqiptare të strukturave ushtarake.

**Zhvillimi i Artilerisë Kundërajrore pas vitit 1945**  
Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe krijimit të



Ushtrisë Popullore Shqiptare, mbrojtja kundërajrore mori një rëndësi të veçantë në sistemin e mbrojtjes së vendit.

Arma e Artilerisë Kundërajrore u zhvillua si një komponent kryesor i mbrojtjes së hapësirës ajrore, duke pasur si mision mbrojtjen e objekteve strategjike, qendrave të banuara dhe forcave ushtarake nga kërcënimet ajrore.

Në vitet e para pas vitit 1945, repartet kundërajrore u pajisën me teknika të trashëguar nga Lufta e Dytë Botërore dhe më pas me armatime të furnizuara nga vendet aleate të kampit socialist. Gjatë viteve 1950–1960 kjo armë njohu një zhvillim të ndjeshëm në organizim, strukturë dhe përgatitje luftarake.

U krijuan reparte, grupe dhe regjimente kundërajrore, të vendosura në pika strategjike të territorit shqiptar. Ato u pajisën me topa kundërajrorë të kalibrave të ndryshëm, mitraloza kundërajrorë një, dy dhe katër grykësh, si dhe sisteme të tjera mbrojtëse. Përgatitja e efektivave të kësaj arme kërkonte disiplinë të lartë, njohuri teknike dhe gatishmëri të vazhdueshme. Ushtarakët e kundërajrorit zhvillonin stërvitje ditën dhe natën, në kushte të ndryshme taktike dhe atmosferike, për të garantuar reagim të shpejtë dhe efektiv.

**Roli i Kundërajrorit gjatë Luftës së Ftohtë**  
Gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, veçanërisht pas viteve 1960, Arma e Artilerisë Kundërajrore mori një rol edhe më të madh në konceptin e mbrojtjes popullore të armatosur.

Në të gjithë territorin e vendit u ngritën pozicione luftarake, pika vrojtimi dhe sisteme paralajmërimi, duke krijuar një rrjet të gjerë mbrojtës. Kjo kërkonte një angazhim të madh njerëzor dhe profesional nga mijëra oficerë, nënoficerë dhe ushtarë që shërbyen në këtë armë. Gjatë viteve 1970–1980,

Artileria Kundërajrore arriti një nivel të lartë organizimi dhe gatishmërie. Repartet morën pjesë rregullisht në stërvitje të mëdha ushtarake, duke treguar aftësi profesionale, disiplinë dhe përkushtim.

Nga viti 1945 deri në vitin 1990, kjo armë ishte një nga shtyllat kryesore të sistemit të mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë. Historia e saj lidhet me punën dhe sakrificën e brezave të ushtarakëve shqiptarë, të cilët kontribuan në ruajtjen e hapësirës ajrore dhe të sigurisë kombëtare.

**Nderim për njerëzit e kësaj arme**  
Në përkujtim të kësaj date të rëndësishme historike, **Grupimi i Ushtarakëve në Lirim dhe Rezervë** organizon ceremoninë e nderimit të kolegëve me eksperiencë shumëvjeçare, duke vlerësuar kontributin dhe profesionalizmin e tyre në përgatitjen e efektivave kundërajrorë dhe në mbrojtje të hapësirës së Republikës së Shqipërisë.

- Me **Certifikatë Mirënjohjeje** nderohen:
1. **Karafil Selmani**
  2. **Vladimir Kalivaçi**
  3. **Agron Sinani**
  4. **Arben Hysi**

Ky vlerësim është një shenjë respekti për përkushtimin, profesionalizmin dhe kontributin e tyre në edukimin dhe formimin e brezave të ushtarakëve të Artilerisë Kundërajrore.

Trashëgimia e kësaj arme mbetet pjesë e rëndësishme e historisë së Forcave të Armatosura Shqiptare dhe dëshmi e përkushtimit të atyre mijëra burrave e grave që i shërbyen mbrojtjes së vendit.

**Lavdi Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë! Nderim dhe respekt për të gjithë kolegët që kanë shërbyer në Armën e Kundërajrorit!**



# 29 QERSHOR 1444: BETEJA E TORVIOLLIT, THEMELI I TRADITËS SË ORGANIZIMIT USHTARAK ARBËROR

**Një fitore që dëshmoi se bashkimi, strategjia dhe udhëheqja ushtarake mund të përballojnë edhe një kundërshtar më të madh në numër**

Në kalendarin e historisë ushtarake shqiptare, 29 qershori i vitit 1444, zë një vend të veçantë. Në këtë ditë, në fushën e Torviollit, në Dibrën e Poshtme, u zhvillua një nga betejat më të rëndësishme të Mesjetës shqiptare – përballja e parë e madhe e ushtrisë arbërore të organizuar pas krijimit të Lidhjes së Lezhës me forcat e Perandorisë Osmane.

Beteja e Torviollit nuk ishte vetëm një përplasje ushtarake mes dy ushtrive. Ajo ishte prova e parë konkrete e aftësisë organizative të një force të bashkuar shqiptare, e cila nën drejtimin e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, arriti të krijojë një model të ri të qëndresës dhe të mbrojtjes së trojeve arbërore.

## Nga Lidhja e Lezhës te krijimi i ushtrisë arbërore

Pas kthimit të tij në atdhe, Gjergj Kastrioti – Skënderbeu kuptoi se përballë fuqisë së Perandorisë Osmane nuk mund të qëndrohej me forca të ndara. Për këtë arsye, më 2 mars 1444, princërit shqiptarë u mbledhën në Lezhë, duke krijuar një bashkim politik dhe ushtarak që do të njihej si Lidhja e Lezhës.

Ky bashkim solli një koncept të ri të organizimit të mbrojtjes: bashkimin e trupave të principatave shqiptare nën një komandë të përbashkët dhe krijimin e një force që do të vepronte sipas një strategjie të unifikuar.

Ushtria arbërore e vitit 1444 nuk ishte një ushtri e madhe në përmasa krahasuar me ushtritë e kohës, por kishte avantazhe të rëndësishme: njohjen e terrenit, motivimin e lartë, disiplinën dhe drejtimin strategjik të një komandanti me përvojë.

## Përballja me ushtrinë osmane

Në vitin 1444, Perandoria Osmane dërgoi një ekspeditë ushtarake drejt trojeve shqiptare, e udhëhequr nga Ali Pasha. Qëllimi ishte goditja e hershme e forcave të bashkuara arbërore dhe dobësimi i autoritetit të Skënderbeut.

Përballë kësaj force të organizuar, Skënderbeu zgjodhi me kujdes vendin e betejës. Fusha e Torviollit i dha mundësi ushtrisë arbërore të përdorte në mënyrë efektive lëvizshmërinë dhe njohjen e terrenit.

Strategjia e tij u mbështet në një kombinim të manovrave mbrojtëse dhe sulmuese, duke përdorur në mënyrë të koordinuar repartet e këmbësorisë dhe kalorësisë.

## Gjenialiteti strategjik i Skënderbeut

Një nga elementët më të spikatur të kësaj beteje ishte përdorimi i zgjuar i rezervave dhe i goditjeve të befasishme.

Skënderbeu nuk u mbështet vetëm te përballja frontale, por organizoi një plan ku trupat shqiptare do të krijonin avantazh përmes lëvizjeve të sinkronizuara.

Forcat e drejtuara nga Gjon Muzaka dhe Hamza Kastrioti ndërhyjnë në mënyrë vendimtare nga prapavija, duke shkaktuar çrregullim në radhët osmane. Më pas, ndërhyrja e forcave të Vrana Kontit ndikoi në përfundimin e betejës në favor të ushtrisë arbërore.

Kjo mënyrë veprimi tregoi një nivel të lartë të mendimit ushtarak, ku fitorja nuk varej vetëm nga fuqia fizike, por nga planifikimi, informacioni dhe koordinimi i forcave.



Beteja e Torviollit nuk ishte vetëm një përplasje ushtarake mes dy ushtrive. Ajo ishte prova e parë konkrete e aftësisë organizative të një force të bashkuar shqiptare, e cila nën drejtimin e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, arriti të krijojë një model të ri të qëndresës dhe të mbrojtjes së trojeve arbërore.

## Rëndësia historike dhe ushtarake e Torviollit

Fitorja në Torvioll pati një jehonë të madhe në kohën e saj. Ajo tregoi se ushtria arbërore ishte një forcë reale dhe se bashkimi i principatave shqiptare mund të përballonte një nga fuqitë më të mëdha ushtarake të shekullit XV. Kjo betejë forcoi autoritetin e Skënderbeut dhe ndikoi në konsolidimin e rezistencës shqiptare për dekada me radhë.

Nga këndvështrimi ushtarak, Torvioll mbetet një shembull i rëndësishëm i:

- përdorimit të terrenit si faktor strategjik;
- organizimit të forcave në bazë të rolit dhe detyrës;
- rëndësisë së komandimit dhe koordinimit;
- ndikimit të moralit dhe motivimit të trupave.

## Torvioll në kujtesën e traditës ushtarake shqiptare

Për shtypin ushtarak, përkujtimi i Betejës së Torviollit nuk është vetëm një rikthim në histori, por një vlerësim i trashëgimisë së artit ushtarak shqiptar.

Çdo ushtri ndërton identitetin e saj edhe përmes kujtesës historike. Njohja e betejave, e figurave drejtuese dhe e përvojave të brezave të mëparshëm ndihmon në kuptimin e rrugëtimit të forcave të armatosura dhe të vlerave që lidhen me shërbimin ushtarak.

Torvioll mbetet një simbol i bashkimit, organizimit dhe aftësisë për të mbrojtur interesat e vendit përballë sfidave të mëdha.

**29 qershor 1444, dita kur ushtria arbërore shkroi një nga faqet më të rëndësishme të historisë së saj ushtarake.**

# FOTO QË NUK DESHA TA BËJA... NË PËRVJETORIN TËND

Në memorie të shokut tonë të armëve – Kolonel Enver Lako (Lelo)



PROF. DR. KRISTAQ XHARO

Pas një viti mundohem të zgjedh një foto për ty. Jo pranë atij “guri”, ku padrejtësisht prehesh, më jep ndjesinë e një kufiri që nuk kapërcehet. Ndërkohë që të gjej në bisedat tona që vazhdojnë ende, te shokët që takoj, në borën dhe ngricat e Fekenit, në breshërinë e çmendur të plumbave të vitit ‘97, në ditët e mëdha të Kosovës, në poligonet ku kaluam orë të tëra, në auditorët me breza oficerësh, në fushën e sportit, pranë tabelës e shahut dhe në qindra kujtime, që edhe sot na bëjnë të buzëqeshim. Prandaj zgjodha një foto pranë stolit me limona. Ajo nuk më kujton mungesën, por praninë e përhershme.

*Kujtesa nuk ecën sipas kalendarit. Ajo ndalet aty ku malli zgjedh të ndalet.*

Më shfaqet fillimisht djaloshi që, pas përfundimit me rezultate të shkëlqyera të Akademisë Ushtarake, nisi rrugën si komandant dhe pedagog. Studentët të donin sepse ish pjesë e tyre. Kishe një humor të hollë që e kthente çdo orë mësimi në një kujtim dhe çdo vështirësi në motivim. Kohë që nuk edukonte vetëm oficerë, por formonte karaktere.

Pastaj kujtesa ndalet te viti i errët 1997. Ishte koha kur karakteri i njeriut vlente më shumë se çdo gradë. Enveri (Lelo) refuzoi, në mënyrë demonstrative, të bëhej pjesë e formacioneve që do të përdorehin kundër popullit në Jug. Nuk bëri zhurmë dhe më vonë nuk kërkoi merita. Veproi sipas ndërgjegjes. Edhe, pak javë më vonë, kur turma të çoroditura kërcënuan garnizonin “Skënderbej”, ti edhe pse në gjendje të rënduar shëndetësore, le familjen dhe u rreshtove në vendroje me një karabinë ‘Simonov’, sepse të tjerat i kishin marrë ‘vullnetarët’. Nuk mbroje godinën; mbroje nderin e uniformës.

Më pas erdhi Kosova. Shumë flisnin për luftën; Enveri punonte në përgatitjen e luftëtarëve të UÇK-së, duke i përcjelle



*Ka njerëz që, edhe pasi largohen nga kjo jetë, vazhdojnë të jenë të pranishëm në kujtesën e atyre që i njohën, në historinë e institucioneve ku shërbyen dhe në vlerat që lanë pas. Kolonel Enver Lako (Lelo) është një prej tyre.*

*Jeta dhe veprimtaria e tij përfaqësojnë rrugëtimin e një oficeri të përkushtuar, pedagogu të dashur dhe ushtaraku me integritet, i cili e lidhi karrierën e tij me edukimin e brezave të rinj, me përgjegjësinë e detyrës dhe me nderin e uniformës.*

*Në këtë përvjetor të ndarjes së tij nga jeta, profesori Kristaq Xharo sjell një kujtim të ndjerë për shokun e tij të armëve dhe të rrugëtimit ushtarak. Përmes fjalëve të tij, ai nuk përshkruan vetëm një mik të humbur, por rikthen figurën e një njeriu që la pas respekt, miqësi dhe shembullin e një oficeri që e vendosi gjithmonë detyrën, atdheun dhe dinjitetin njerëzor mbi çdo interes tjetër.*

*Ky dedikim është një dëshmi e lidhjes së fortë mes bashkëluftëtarëve, e kujtesës që ruan emrat e atyre që i shërbyen me përkushtim Forcave të Armatosura dhe e vlerësimit që brezat u japin njerëzve që kanë lënë gjurmë në historinë ushtarake.*



drejt frontit me përkujdesjen e vëllait. Vite më vonë, njëri prej tyre më tregonte se, pasi ishte ankuar me humor për lodhjen e stërvitjes, Enveri i ishte përgjigjur: “Më mirë të më kujtoni për këtë lodhje, sesa për atë që nuk ju mësova. Le të kthehemi të gjithë me fitore dhe pranë familjeve”.

E më pas...përfundimi me rezultate të shkëlqyera i Akademisë së Drejtimit në Gjermani, nga më të famshmet në botë, i kthyer me të njëjtën thjeshtësi me të cilën ishte nisur. Dijen nuk e përdori kurrë për t’u ngritur mbi të tjerët, por për të ecur së bashku. Më pas erdhi Afganistani me medalje dhe vlerësimet më të larta nga NATO.

Por, nëse do të kishte një vend ku Lelo e fitoi betejën më të bukur të jetës, ai ishte familja. Bashkë me Majlindën ndërtoi një shtëpi ku dashuria, ndershmëria, edukimi dhe dinjiteti

nuk ishin thjesht fjalë, por mënyrë jetese. Kristi dhe Elio janë sot vazhdimësia më e bukur e asaj trashëgimie morale që ai u la.

Jeta nuk ishte gjithmonë bujare, sepse ndershmëria, profesionalizmi dhe refuzimi për të bërë kompromis me ndërgjegjen nuk i sollën gjithmonë shpërblimin që meritonte. Por ai nuk e ndërroi kurrë dinjitetin me karrierën. Për këtë arsye ai fitoi diçka shumë më të madhe: respektin e të gjithëve.

Kur bisedojmë së bashku kujtesa më çon në shumë vende, të vështira, por edhe mbresëlënëse: në auditorë, poligone, stërvitje, Feken, por edhe në ditët e zakonshme. Kujtoj se një ditë më duhej ta zëvendësoja në mësim dhe studentët nisën të më rrëfenin “legjendat” e pedagogëve të tyre të zjarrit. Për njërin thoshin se shkruante emrin me plumba në tabelë, për një tjetër se vizatonte figura gjeometrike gjatë qitjes, ndërsa për Lelon se ishte mjeshtër i goditjes së objektivave në fluturim. Edhe unë duhej të bëja diçka që të mbetej në memorien e studentëve edhe pse e dija që vështirë t’ia arrija... Fati ma solli që Lelo erdhi në poligon dhe unë mendova se do të shpëtoja nga prova. Gabova. Ai u bashkua me studentët dhe unë mbeta në “bankën e provës”. ‘Fati’ deshi që objektivi, i vendosur në 600 m larg brenda frëngjisë së bunkerit, të merrte flakë nga goditjet. Studentët shpërthyen në duartrokitje. Lelo qeshte më shumë se të gjithë. Nuk gëzohej për rezultatin tim; gëzohej sepse e kishte natyrë të ndante gëzimin e tjetrit.

Po aq i gjallë më shfaqet në ndeshjet e futbollit, duke udhëhequr ekipin e Katedrës së Zjarrit kundër “kombëtares” së Fizkulturës, ekip kampionësh. Brohoritjet e studentëve për më të dobëtit (neve) mjaftonin për ta kthyer Lelon përherë në djalosh. Nuk e jetonte lojën vetëm për të fituar, por për t’u bashkuar me njerëzit. E shoh edhe pranë tabelës së shahut, në ato “beteja” plot humor me profesor Ribajn, ku fituesi i vërtetë ishte gjithmonë miqësia dhe humori.

Edhe pasi hoqi uniformën, ai nuk u largua kurrë nga njerëzit. Telefoni i tij vazhdonte të binte nga ish-studentët, kolegët, shokët e Afganistanit dhe të Kosovës. Nuk kërkonin kolonelin. Kërkonin Lelon. Kërkonin njeriun që dinte të dëgjonte, të këshillonte, të qeshte dhe t’i bënte të gjithë të ndiheshin më mirë me praninë e tij.

Këto janë vetëm disa kujtime të shkëputura nga më shumë se katër dekada shoqëri dhe që mjaftojnë, megjithatë, që të mos ndalem vetëm pranë një ‘guri’ për të të kujtuar. Më pëlqen më tepër të të kërkoj në fotografitë e jetës. Aty mbetesh Ti...

Ka njerëz që lënë pas një karrierë e ka të tjerë që lënë pas një emër. Ti, Lelo, na le diçka shumë më të madhe: një mënyrë për të jetuar me dinjitet, për të shërbyer pa zhurmë, për të udhëhequr pa imponim dhe për të qenë mik pa kushte.

Pushofsh në paqe, shoku ynë i armëve. Malli për ty nuk matet me vitet që kalojnë, por me boshllëkun që ke lënë mes nesh. Kujtimi yt nuk jeton mbi një gur. Ai jeton në secilin prej nesh.

# KUPTIMI DHE HISTORIA E PËRSHËNDETJES USHTARAKE

Thuhet se romakët ishin të parët që përdorën një gjest me dorë si shenjë respekti ndaj oficerëve. Ushtarët ngrinin dorën si shenjë respekti ndaj oficerëve, duke treguar besnikëri dhe nderim. Ky gjest i thjeshtë u bë simbol i disiplinës dhe i rendit ushtarak. Disa historianë sugjerojnë se, në një epokë kur atentatorët ishin të zakonshëm, ngritja e dorës së djathtë ishte një gjest për të treguar se një ushtar romak nuk po fshihte ndonjë armë. Më vonë, gjatë Mesjetës, ky veprim u përshtat për të dalluar miqtë nga armiqtë. Deri në shekullin XVIII, ushtritë e Europës dhe Amerikës së Veriut e kishin përfshirë përsëritjen si pjesë të protokollit të tyre, duke e përdorur në çdo situatë ushtarake si shfaqje nderimi.

Në traditën ushtarake, gjithmonë është nënoficeri që përsëritet i pari oficerin me gradë më të lartë. Megjithatë, mënyra e kryerjes së përsëritjes ndryshon sipas degës së forcave të armatosura dhe vendit që përfaqësohet. Ky gjest përdoret në shumë raste të ndryshme, duke u konsideruar i domosdoshëm në ceremoni dhe situata të veçanta.

Por cilat janë format e ndryshme të përsëritjes ushtarake dhe kush tjetër, përveç personelit ushtarak, ka të drejtën të marrë një përsëritje të tillë?

### Mesjeta: Mik apo armik?

Në Mesjetë, kalorësit ngrinin vizorin e helmetës për të zbuluar fytyrën, duke treguar se nuk ishin armiq. Ky veprim u shndërrua në një ritual sigurie, por edhe respekti, duke ndihmuar në dallimin e miqve nga kundërshtarët.

Ky gjest është interpretuar nga disa studiues të historisë mesjetare si origjina e përsëritjes moderne ushtarake perëndimore, pasi ai shfaqte një fytyrë miqësore dhe tregonte se në dorën e djathtë nuk mbahej asnjë armë.

Deri në shekullin XV, ky gjest kishte evoluar dhe ishte bërë një mënyrë e përhapur për të treguar respekt, shpesh duke përfshirë edhe heqjen e kapelës.

### Përsëritja e trupave, nga tradita në protokoll

Disa shekuj më tej, George Washington u paraqit në një



litografi të ngjyrosur me dorë, teksa merrte komandën e Ushtrisë Amerikane në Cambridge, Massachusetts, më 3 korrik 1775, duke përsëritur trupat e tij përmes heqjes së kapelës.

Me zhvillimin e ushtrive moderne në Europë dhe Amerikë, përsëritja u kodifikua si pjesë e protokollit zyrtar. Ajo u bë një gjest i rregullt, i detyrueshëm, që pasqyronte hierarki dhe disiplinë brenda trupave ushtarake.

Në traditën ushtarake, gjithmonë është nënoficeri që përsëritet i pari oficerin me gradë më të lartë. Megjithatë, mënyra e kryerjes së përsëritjes ndryshon sipas degës së forcave të armatosura dhe vendit që përfaqësohet. Ky gjest përdoret në shumë raste të ndryshme, duke u konsideruar i domosdoshëm në ceremoni dhe situata të veçanta.

Në kontrast, që prej vitit 1917 përsëritja e Ushtrisë Britanike kryhet me dorën e djathtë, me pëllëmbën e kthyer përpara dhe gishtat pothuajse duke prekur kapelën ose beretën. Adoptimi fillestar i këtij gjesti u ndikua ndjeshëm nga larmia e mbulesave të kokës ushtarake të kohës.

Në ushtri, gjithmonë është nënoficeri apo ushtari që përsëritet i pari oficerin e lartë. Ky detaj i vogël përforcon rendin hierarkik dhe respektin e ndërsjellë, duke ruajtur strukturën e komandës.

### Variacionet ndërkombëtare

Stili i përsëritjes ndryshon sipas vendit dhe degës së ushtrisë. Në disa vende dora vendoset drejt ballit, në të tjera drejt kapelës, ndërsa marina ka variante të veçanta për shkak të kushteve të shërbimit në det.

### Njohja e Kreut të Shtetit

Në Mbretërinë e Bashkuar, zakoni i përsëritjes së





oficerëve lidhet tërësisht me pozicionin drejtues të dhënë nga Mbreti Charles III për atë oficer, dhe jo me personin vetë. Prandaj, kur një nënoficer i Forcave Ajrore, për shembull, përshëndet një oficer, ai në mënyrë indirekte po njeh Mbretin si Kreun e Shtetit. Një përshëndetje e kthyer nga oficeri bëhet në emër të monarkut.

#### Përshëndetja në Shtetet e Bashkuara

Përshëndetja ushtarake në Shtetet e Bashkuara bazohet në atë që përdorej nga personeli i Marinës Britanike gjatë shekujve XVIII dhe XIX.

#### Mënyra Amerikane

Në Shtetet e Bashkuara, përshëndetja ushtarake kryhet me dorën e djathtë, duke e mbajtur pëllëmbën të kthyer poshtë drejt shpatullës.



#### Përshëndetja e Komandantit të Përgjithshëm


Në Shtetet e Bashkuara, protokolli kërkon që, përveç oficerëve, gjithmonë të përshëndetet presidenti i Shteteve të Bashkuara.

Anëtarët e Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara, Forcës Ajrore dhe Forcës Hapësinore japin përshëndetje si me kokën të mbuluar, ashtu edhe të pambuluar. Megjithatë, përshëndetja brenda ambienteve të mbyllura nuk është e detyrueshme, përveç rasteve kur raportohet zyrtarisht tek një oficer epror ose gjatë një ceremonie të brendshme.



#### Përshëndetja e Veteranëve

Rastet kur duhet dhënë përshëndetja përfshijnë ngjarje ceremoniale, për shembull kur nderohen veteranët si këta të mbijetuar të USS Arizona, të cilët shpëtuan nga anija luftarake e dënuar gjatë sulmit në “Pearl Harbor” në vitin 1941.



#### Përshëndetja e flamurit

Në vende të tjera, përshëndetja jepet gjatë ngritjes dhe uljes së flamurit, madje edhe kur një ceremoni e tillë zhvillohet në Hënë.



#### Përshëndetje ndryshe

Në këtë fotografi, komandantët e tankeve polakë po japin përshëndetjen nga mjeti i tyre. Por a vini re ndonjë ndryshim në mënyrën se si realizohet ky gjest?

Është zakon në forcat e armatosura polake që përshëndetja të bëhet me dy gishta. Ky gjest ka gjasa të datojë që nga fundi i shekullit XVIII dhe është unik për ushtrinë polake.



#### Përshëndetja Fashiste

Përshëndetja fashiste, e përdorur për herë të parë nga anëtarët e Partisë Kombëtare Fashiste të Italisë në vitet 1920, shpesh përshkruhet gabimisht si një përshëndetje romake, megjithëse asnjë tekst romak nuk përshkruan një gjest të tillë.



#### Përshëndetja Naziste

E frymëzuar nga përshëndetja fashiste, përshëndetja naziste u përdor zyrtarisht nga Partia Naziste në vitin 1926, megjithëse ishte përdorur brenda partisë që në vitin 1921.

#### Përshëndetja e Hitlerit

Përshëndetja sinjalizonte bindje ndaj udhëheqësit të partisë, Adolf Hitler, si dhe lavdërimin e kombit gjerman. Ky gjest u modifikua nga diktatori nazist në shumë raste, kur ai filloi të jepte “përshëndetjen e Hitlerit” me pëllëmbën paralele me qiellin. Përdorimi i përshëndetjes fashiste është i paligjshëm në Gjermaninë e sotme, si edhe në Austri, Sllovaki dhe Republikën Çeke.

#### I pari ndër të barabartët

Në dhjetor 2010, pasi Ministria e Mbrojtjes e Koresë së Jugut pranoi të lejonte gratë në Programin e Oficerëve Rezervë të bazuar në kolegje për herë të parë që nga fillimi i tij në vitin 1963, kadetet femra në Universitetin e Grave Sookmyung u fotografuan duke dhënë një përshëndetje në stilin e Ushtrisë Amerikane gjatë ceremonisë së themelimit të Korpusit të Trajnimit të Oficerëve Rezervë për kadetet femra në Universitetin e Grave Sookmyung.

#### Përshëndetja dhe përkulja

Personeli ushtarak japonez jep përshëndetjen me dorë në çdo rast kur përshëndet një pjesëtar tjetër të shërbimit ushtarak ose një homolog, pavarësisht nga grada. Ashtu si në ushtrinë amerikane, përshëndetja në Japoni zakonisht kufizohet në ambiente të hapura. Në mënyrë të veçantë, nuk është e pazakontë që personeli ushtarak japonez të përkulet gjithashtu. Në fakt, përshëndetja dhe përkulja janë praktika të zakonshme dhe shumë të respektuara si në sektorin ushtarak, ashtu edhe në atë civil.

#### Përshëndetja ushtarake në Shqipëri: Nga Skënderbeu tek standardet moderne

Tradita e përshëndetjes ushtarake në Shqipëri ka rrënjë të hershme, që lidhen me kohën e Skënderbeut. Edhe pse nuk ekzistonte një formë e kodifikuar si sot, shkrimet historike përmendin se luftëtarët e tij shprehnin respektin ndaj komandantit dhe flamurit duke ngritur armët, vendosur dorën mbi gjoks ose duke u përkulur lehtë. Këto gjeeste ishin të lidhura ngushtë me kulturën e besës dhe nderit, që përbënin bazën e disiplinës ushtarake shqiptare.

Në periudhën e Mbretërisë Shqiptare, përshëndetja zogiste u vendos nga Mbret Zogu I si simbol besnikërie ndaj kombit dhe monarkisë. Ajo konsistonte në vendosjen e dorës mbi zemër dhe u përdor gjerësisht nga Garda Mbretërore dhe ushtria e kohës, duke u bërë pjesë e ceremonive shtetërore.

Pas Luftës së Dytë Botërore dhe gjatë regjimit komunist, ushtria shqiptare adoptoi modele të tjera disiplinore, të ngjashme me ato të vendeve të bllokut lindor. Përshëndetja me dorë drejt ballit u bë normë, duke shprehur respekt ndaj hierarkisë dhe flamurit, dhe u përdor në çdo ceremoni zyrtare.

Me ndryshimet demokratike pas vitit 1990 dhe integrimin e Shqipërisë në NATO, Forcat e Armatosura Shqiptare u përshtatën me standardet e aleancës. Sot, përshëndetja zyrtare është ajo klasike me dorën e shtrirë drejt ballit, e cila përdoret në çdo rast ceremonial, gjatë ngritjes së flamurit, nderimit të eprorëve dhe protokolleve ndërkombëtare.

#### Përtej ushtrisë

Përshëndetja ushtarake, në çdo vend dhe periudhë historike, është më shumë se një gjest formal: ajo është një shprehje e respektit, disiplinës dhe identitetit kolektiv. Nga gjestet e thjeshta të luftëtarëve të Skënderbeut, tek përshëndetja zogiste e Mbretërisë Shqiptare, e deri tek standardet moderne të NATO-s, ky akt ka mbajtur gjithmonë gjallë idenë e nderimit ndaj flamurit, autoritetit dhe kombit. Në vende të tjera, si Shtetet e Bashkuara, Britania apo Polonia, përshëndetja ka marrë forma të ndryshme, por gjithmonë ka pasur të njëjtin kuptim: të shprehë besnikëri dhe respekt institucional.

Përtej ushtrisë, përshëndetja ushtarake është bërë pjesë e ceremonive shtetërore, parakalimeve dhe momenteve solemne që kërkojnë nderim kombëtar. Ajo i drejtohet jo vetëm eprorëve dhe flamurit, por edhe figurave shtetërore dhe personaliteteve që përfaqësojnë autoritet dhe dinjitet. Në këtë mënyrë, përshëndetja ushtarake është një gjuhë e përbashkët e respektit, që lidh traditat e hershme me protokollet moderne, duke e bërë atë një element të pandarë të kulturës dhe identitetit kombëtar në mbarë botën. Kështu, analiza e përshëndetjes ushtarake na tregon se ky gjest i thjeshtë, i përsëritur në çdo ceremoni, është në fakt një simbol i fuqishëm i historisë, disiplinës dhe respektit që shoqëritë njerëzore i japin autoritetit dhe flamurit të tyre.



# ATDHEU NDERI DETYRA